

PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 26.11.2025, në orën 11:00, në sallën e këshillit bashkiak, në Pallatin e Kulturës Lezhë, mbi mbledhjen e radhës të muajit Nëntor 2025, të Këshillit të Bashkisë Lezhë.

Mbledhja u hap nga kryetari z. Ndue Luli, i cili lexoi rendin e ditës.

-Ndue Luli: Përshëndetje të gjithëve. Faleminderit për pjesëmarrjen.

Sot kemi mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin nëntor, me rend dite si më poshtë.

1. Projekt-vendim “Për përdorimin e fundit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% në periudhën 01-31 Tetor 2025”
2. Projekt-vendim “Për miratimin e nivelit të taksave, tarifave vendore për shërbimet publike dhe ato administrative, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penalteteve ndaj kundërvajtësve”
3. Projekt-vendim “Për një shtesë në vendimin nr. 74, datë 25.09.2024 “Për miratimin e pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë, të punonjësve administrativë, të punonjësve mbështetës dhe të masës së shpërblimit mujor të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave” i ndryshuar”
4. Projekt-vendim “Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr. 99, datë 19.12.2024 “Për miratimin e PBA-së 2025-2027 dhe Buxhetit të vitit 2025”
5. Projekt-vendim “Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi të bashkisë, për kryerjen e aktivitetit minerar në objektin Gjobardhaj nga shoqëria “Gjoni” shpk”
6. Projekt-vendim “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit për ndërtimin e Qendrës Ditore të Moshës së Tretë në Lezhë”
7. Projekt-vendim “Për miratimin e shpërblimit për 20 maturantët me mesataren më të lartë në Maturën Shtetërore 2024-2025”
8. Projekt-vendim “Për miratimin e memorandum mirëkuptimi ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD) dhe Bashkisë Lezhë, si dhe miratimin e përdorimit të fondeve për organizatat e shoqërisë civile të miratuar me VKB nr. 99, datë 19.12.2024”
9. Projekt-vendim “Për miratimin e marrëveshjes së përbashkët ndërmjet Komunës Cetinje (Prejstonica Cetinje) dhe Bashkisë Lezhë për projektin “SMART LAND 2.0. - Lëvizshmëria e Qëndrueshme e ndërlidhur me Transportin Publik në Zonat Rurale në Adriatikun Jugor””
10. Projekt-vendim “Për shpalljen Qytetar Nderi i Bashkisë Lezhë të sportistit Jurgen Uldedaj”

11. Projekt-vendim “Për miratimin e Planit Tematik Vjetor të Këshillit të Bashkisë Lezhë për vitin 2026”

12. Informacion mbi realizimin e buxhetit për 10 mujorin e vitit 2025.

Krahas këtyre projekt-vendimeve kemi dhe tre projekt-vendime shtesë, dy prej të cilëve jeni të njohur me to, po i lexojmë, pastaj kemi dhe një të tretë.

Projekt-vendim “Për shpalljen e datës 1 Mars si festë lokale “Dita e Arbëreshëve””

Projekt-vendim “Për miratimin e krijimit të bandës muzikore të qytetit”

Kemi dhe një projekt-vendim tjetër që duhet ta miratojmë sot së bashku, “Për mosndryshimin e çmimit të ujit në Bashkinë Lezhë”, pasi, sipas një shkrese të ardhur edhe nga shoqëria anonime e ujësjellësit, kërkohet vendimi i këshillit për një gjë të tillë, sepse ndryshe mund të ndryshojnë dhe çmimet. Kështu që ky është projekt-vendimi, i cili do të jetë në dispozicionin tonë shpejt. Atëherë, kush është dakord me projekt-vendimet?

Po, ka diçka? Po.

-Donika Ndoj: Përshëndetje të gjithëve. Në fakt, këtu para na paraqiten në këshill 13 projekt-vendime dhe një relacion apo dhe të ndryshme, kur konkretisht ne nuk kemi para një plan masash konkrete për përmbytjet në Lezhë, që është një problem që lidhet drejtpërdrejt me qytetarët dhe banorët e Lezhës. Prandaj, do të kishte qenë më etike dhe më e udhës që një ndër këto projekt-vendime, apo njëfarë relacioni, ta kishim në lidhje me masat që janë marrë, apo që do të merren në lidhje me përmbytjet në qytetin e Lezhës. Faleminderit.

-Ndue Luli: Atëherë, sa për sqarim, te pika “Të ndryshme” kemi të drejtë secili nga ne që ta ngremë me forcë, sepse është problematikë jo vetëm lokale, por edhe mund të themi kombëtare, këtë problem të cilin e ngriti këshilltarja me të drejtë. Por për projekt-vendime, tani për tani ne s’kemi pse të marrim, megjithatë ju mund të kenë propozimet tuaja.

Atëherë, kush është dakord me projekt-vendimet që lexuam pak më sipër? Ju lutem, kartonat. Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 34 vota PRO. Faleminderit.

Vazhdojmë me projekt-vendimin e parë. Projekt-vendim “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 1-31 Tetor 2025”.

Kush është dakord? Ju lutem, kartonat. Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 34 vota Pro. Faleminderit.

Projekt-vendimi i dytë “Për miratimin e nivelit të taksave, tarifave vendore për shërbimet publike dhe ato administrative, lehtësirat fiskale, strukturat e vjetës së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundërvajtësve”.

Në lidhje me këtë projekt-vendim, i cili është i një rëndësie të madhe për vazhdimin e punës së bashkisë tonë, kush e do fjalën? Në qoftë se keni pyetje, mirë, sepse për sqarime, të na sqarojë pak edhe drejtoria përkatëse. Si mendoni ju? A jeni dakord? Kështu që fjalën e ka drejtori i taksave. Të dëgjojmë, sepse ju lutem, pse po e themi drejtoria e taksave dhe tarifave vendore? Për arsye sepse dhe një relacion që e kemi marrë në dorë, paraqet disa pika kryesore të cilat kanë ndryshim me vendimin që kemi patur vitin që shkoi. Kështu që ai relacioni është bërë që ne si

këshilltarë të jemi të qartë se ku janë ndryshimet. Por mund të ketë edhe ndonjë diçka tjetër të cilën mund ta shtojmë këtu. Kështu që prandaj po i japim fjalën. Fjalën e ka drejtorja.

-Denis Pervathi: Përshëndetje. Ndryshimet në paketën fiskale janë disa ndryshime sipas mendimit tim, apo edhe reagimet që kemi pasur në komision, sepse janë bërë disa ndryshime, kryesisht janë tek tarifat e shërbimeve, disa tarifa që prekin veç fashën e subjekteve të mëdha. Për shkak të kostos së rritur kemi bërë disa ndryshime. Janë disa ndryshime të vogla që mund të flasë drejtorja e shërbimeve dhe drejtorja e urbanistikës. Pjesa e taksës për familjarë nuk ka pasur ndonjë ndryshim, veç pjesa e tarifës së mirëmbajtjes së varrezave publike ka pasur një rritje për dy zona, zonën A dhe zonën B. Të tjera ndryshime thelbësore nuk ka pasur. Është me rëndësi që të theksohet që taksa kryesore, taksa e pasurisë nuk ndryshon, taksa e fjetjes nuk ndryshon, taksa e përkohshme nuk ka rritje, taksa e tabelës nuk ndryshon, domethënë taksat kryesore, taksa e TNI, taksa e infrastrukturës nuk ka një rritje, domethënë për të gjitha taksat kryesore rritja është zero. Veç ka disa detajime që kemi sqaruar në një relacion. Kush ka ndonjë pyetje, diskutim, për sqarime? Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Atëherë, kush e do fjalën? Zonja Ndoj.

-Donika Ndoj: Në fakt, paketa fiskale është një dokument mjaft i rëndësishëm pasi prek taksat edhe tarifat në lidhje me individët, bizneset, apo edhe për pronarët. Në lidhje me këtë projekt-vendim, disa pyetje që mund të ngrejme është sepse, në fakt, ne nuk kemi një tabelë këtu që na tregon për lëvizjen e këtyre taksave dhe tarifave për tre vitet e fundit, të paktën tre vitet e fundit, për të bërë një krahasim. Ju po trumbetoni për buxhetin më të madh, në fakt, në bashki, por nga ana tjetër, INSTAT thotë që kemi ulje të popullsisë, EUROSTAT thotë që kemi dhe ulje të nivelit të të ardhurave për popullsinë, ndërkohë që ku do të merren këto taksa? A i keni rritur aq shumë këto taksa ju? Dhe kena pastaj këtë pjesën që e gjetëm këtu në relacionin ku thuhet bizneset. Për bizneset më bëri përshtypje dhe 100% që të rritet edhe taksa, 75 ka shku 150. Ju keni bërë dhe një dëgjese publike.

2025 dhe 2026 flet për një tarifë goxha të lartë edhe shumë, jo vetëm kjo, por të gjitha bizneset në përgjithësi që të cilat do të paguajnë tarifa të larta. Atëherë, në kurriz të këtyre bizneseve do të rritet aq shumë buxheti, ndërkohë që edhe bizneset nuk është se kanë pasur ndonjë fitesë shumë të madhe në krahasim edhe me vitet e tjera, sepse edhe këto bizneset i bëjnë njëfarë relacioni vetes, të cilët kanë disa deficite edhe këta. Kështu që për bizneset pak thikë me dy presa është. Edhe diçka, më bëri përshtypje, lehtësim për nënat kryefamiljare të cilave do t'u lehtësohet deri në 50% të tarifave për të hapur biznesin nëna me tre fëmijë. Me tre fëmijë tani quhet nënë me shumë fëmijë dhe nuk është se kanë marrë iniciativë që të hapin biznes ato. Kështu që është pak që nuk ka sens, po mund ta kishit ulë pak me një fëmijë apo dy fëmijë, por nënë me tre fëmijë që do të merret edhe me biznes... Kështu që janë disa detaje që duhet për me i pa në këtë paketë fiskale.

-Ndue Luli: Fjalën kryetari.

-Pjerin Ndreu: E para e punës kjo paketë fiskale duhet të ndahet në dy pjesë. E para te familjarët, kjo nuk i prek fare, përjashtoj problemin e funeraleve dhe të varrezave, sepse kemi një problem serioz atje që ne na duhet me ndërhy, na kërkohet me zgjeru, na kërkohet me bë veprime të tjera aty, me pastru, me shpenzu dhe ne s'marrim asnjë lek. Kjo tregon se ne duhet ta taksojmë sikur është në gjithë botën, sikur është në gjithë Shqipërinë, edhe për varrim dhe ta disjplinojmë këtë

histori. Pra, nuk ka një ngarkesë fiskale që shkon te banorët. E para, që është pozitive. Pastaj te biznesi, ka disa tarifa që kanë lidhje me ndotjen që janë ndotësit më të mëdhenj dhe ne nuk mund të tolerojmë më. Nuk mund të tolerojmë më, sepse ne jemi në pragun e miratimit të një skeme të re pastrimi dhe ne nuk mund të tarifojmë më shumë banorët në kurriz të ndotësve më të mëdhenj. Dhe në gjithë testet që kemi bërë ne, edhe me ato kamerat që bëmë ne, edhe me të dhënat që marrim ne nga terreni, gjithë sistemi i supermarketeve, i marketeve të vogla, sistemi i lokaleve të dasmave, sistemi i restoranteve, të mishit të peshkut dhe të gjithë që i marrin ato mbeturinat organike e i hedhin atje, janë ndotësit më të mëdhenj dhe më të rrezikshëm që ne kemi. Duke qenë se janë ndotësit më të rrezikshëm dhe më problematikë, që në fakt menaxhimi im i mbetjeve dhe nuk e njeh fare, këta do paguajnë më shumë, sepse atëherë ne do adresojmë masa të tjera. Dhe në masat e tjera hyn edhe ndarja në burim që do bëhet së shpejti me GIZ. Pra, është një zinxhir dhe normalisht biznesi, edhe familjarët mund të paguajnë më tepër, por për rastin konkret nuk e kemi prek, sepse është cilësi jetese. Nuk është një investim që shkon as për investime dhe as për asgjë. Është cilësi jetese në formën e përmirësimit të ambienteve që ne kemi shumë problem. Kur vjen puna me filmu, shkojmë vrap. Kur vjen puna me parandalu dhe me thënë, me vëzhgu, një market fruta-perime më bën ndotje sa bëjnë gjithë familjarët bashkë në një lagje. Kjo është absurde. Atëherë, çfarë të them? Nqs nuk zënë mend, atëherë do paguajnë lekë, sepse ne shpenzojmë energji më tepër. Ne shpenzojmë tre herë për t'i marrë me punonjësit tanë. Ne po e kompensojmë me punonjësit tanë, sepse kompania dy herë t'i merr. Nuk t'i merr pesë herë. Ne detyrohemi të fusim ekstra punonjësit tanë aty, pa i llogaritur fare në koston e kësaj që kemi. Dhe është krejt normale dhe nuk ka ndonjë rritje kushedi se ça. Janë rritje të maturuara, por që janë të studiuara për shkak të tipologjisë së biznesit i cili ndot.

-Ndue Luli: Faleminderit. Kush e do fjalën? Sqarim nga Zoti Marku.

-Agostin Marku: Tani, unë gjykoj, edhe si kryetar i komisionit të financës dhe buxhetit, gjykoj që Bashkia e Lezhës me këtë paketë fiskale që na sjell sot, flet për konsolidim të sistemit të taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë së Lezhës. Fakti që taksat nuk lëvizin, por edhe fakti shumë domethënës që buxheti është parashikuar me një rritje galopante, do të thotë për stabilitet dhe menaxhim të shkëlqyer të sistemit të taksave në Bashkinë Lezhë. Ne kemi zakon e kapim vetëm ato të cilat i tha edhe kryetari i bashkisë dhe unë s'dua t'i përmend, as s'dua t'ju ha kohë, por përmendim vetëm atë pjesën ku shohim rritje të tarifave të shërbimeve, tarifave të atyre shërbimeve të cilat, gjithsecilit nga ne, sidomos në periudhën e pikut të verës, të gjithë akuzojnë bashkinë sepse i lejon bizneset me gjithë këtë volum që kanë zënë rrugën, që kanë zënë trotualet e tjera, e tjera, e tjera. Por të gjitha këto duan një kosto të konsiderueshme që të pastrohen. Ndaj është bërë edhe ajo rritje. Dhe madje, edhe kjo rritje të tarifave është shumë e kujdesshme. Pse është e kujdesshme? Sepse thotë mbi bazën e xhiros. Pra, në qoftë se ke një volum të madh xhiroje, pse s'duhet të paguash më tepër sesa të tjerët? Dhe nuk preken fare qytetarët. Por ne nuk shohim edhe pjesën tjetër që tek sistemi i taksave, edhe bizneset kanë favorizime, te ato lehtësirat që i ka nxjerrë drejtoria e taksave. Për shembull, kemi rastet që s'ka ndodhur asnjëherë në paketën fiskale të viteve të tjera. Pra, edhe kjo flet për konsolidim, edhe për një ndërgjegjësim, edhe të bashkisë për sistemin e taksave dhe tarifave vendore. Dhe kemi rastin e taksave për bizneset, për shembull, një lehtësim që thotë që paguajnë jo për ato sekondare, por vetëm për selinë qendrore. Lehtësim është për bizneset. Kemi një pikë tjetër që thotë kur aplikojnë për çregjistrim, pra nuk paguajnë gjithë taksat, por i llogaritet në proporcion për kohën. Kemi një tjetër përsëri për biznesin. Pra, duhet të përmendim edhe këto raste ku themi për pasuritë, për

ndërtesat, për tokën e për tjera, tjera. Nuk ka penalitete, edhe në qoftë se i gjejmë më tepër, nuk ka penalitete, por duhet të paguajnë taksat dhe tarifën për atë që i gjetëm më tepër. Në qoftë se përpara ne e kishim në paketën fiskale që të paguajnë penalitete, tani jo. Kemi një rast tjetër që e stimulojmë ose e nxisim biznesin në tërësi, që i themi në qoftë se ti i paguan deri në 10 ditë para, ulët 5%. Pra, edhe ky është një favorizim që i bën bizneseve. Pra, ka një sërë favorizimesh, por ka një diçka, për shërbimet të cilat ne po shohim kostoja e gjithnjë po vjen, e rritet, që i themi ti ke xhiro shumë, po dhe ndotja është më e madhe kur ke xhiro shumë, do paguash një tarifë që kjo rritje nuk është aq e madhe, mund të shkojë 10% ku ta di unë me vlerën e taksës që ka qenë, jo 10% të rritet. Kështu që në tërësi, unë mendoj duke parë këtë stabilitet, duke mos pasur rritje, pra nga viti në vit, ne kemi shkuar në konsolidimin e çështjes së menaxhimit të taksave dhe tarifave, edhe për faktin se pavarësisht që nuk i rrisim taksat dhe tarifën dhe ka një stabilitet të tillë, e shohim se të ardhurat rriten gjithnjë e më shumë në Bashkinë e Lezhës, të ardhura nga ky sistem i paketës fiskale, të ardhura nga grantet e ndryshme, nga projektet, e tjera, tjera që nuk janë objekt i kësaj mbledhjeje, por janë një mbledhje tjetër, dhe në tërësi themi që ka një konsolidim, një ndërgjegjësim, por edhe rritja e të ardhurave në vetvete nga paketa fiskale në tërësi vjen edhe nga shfrytëzimi i mirë i taksës së ndikimit në infrastrukturë. Çka dhe kjo është diçka serioze. Ndaj unë, edhe si këshilltar, edhe si kryetar i komisionit të financës, ju ftoj të gjithëve që ta miratojmë, sepse e shoh si paketë të konsoliduar dhe mbi baza ligjore. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit.

-Pjerin Ndreu: Edhe një sqarim që të jemi më të qartë.

-Ndue Luli: Po, zoti kryetar.

-Pjerin Ndreu: Ne kemi futur në sistem taksimi të gjithë lejet e ndërtimit që vijnë në kuptimin edhe të ndotjes, por edhe të pagimit të disa tarifave të cilat i kanë të domosdoshme dhe për shkak edhe të ngritjes së kantierëve, të ndotjes që krijojnë, të problemeve që krijojnë me trafikun dhe të tjera. Vijnë zinxhir ato dhe i kemi futur. Edhe po t'i marrim gjithë këto subjekte që kemi futur në të tjera, kanë rritje të lehta, përjashtoj ndonjëra që vjen, edhe fillon me tregti mishi, tregti peshku, tregti ushqimore, fruta-perime, tregti industriale, tregti materiale ndërtimi, të gjitha janë ndotës. Kemi tarifuar edhe të gjithë investimet që janë miratu te investimet strategjike, parkun eolik, këtu si do ta bëjmë me 0.1% tarifën, njëllon sikur po vë në shtëpi panele diellore? Nuk është e njëjta gjë. Kemi ndarë familjarët me një anë dhe kemi futur biznesin që investon për shkak të industrisë dhe bën një park me investime me panele diellore, si do ta tarifojmë? Do ta tarifojmë njëllon sikur e kanë banesat? Pra, i kemi ndarë me logjikë.

-Ndue Luli: Faleminderit. Kush e do fjalën? Zonja Haxhia.

-Donika Haxhia: Përsëritet. Atëherë, diçka që më ra në sy, domethënë që në fillim, se tani ne e dimë që taksat dhe tarifën janë një prej burimeve që i nevojiten bashkisë për t'i përkthyer ato në shërbime ndaj qytetarëve. Por që në fillim më ra në sy ndarja administrative territoriale, krahasuar me paketën fiskale të vitit të kaluar, ku ka qenë e ndarë në tre zona: A, B dhe C, ndërsa sivjet na paraqitet me dy zona: A dhe B. Zona A ka mbetur siç ka qenë dhe te zona B është bashkuar dhe zona C, dhe bie në sy tek tarifën, që zona C tashmë futet tek zona B dhe tarifën i rriten me mbi 30%. Tani, nuk e di, pse është bërë ky ndryshim, pse është hequr një zonë C, a justifikohet kjo me cilësinë e shërbimit që do bëhet në këto zona? Dhe po i referohem edhe asaj

që tha zoti Agostin, në zonën C a është rritur xhiroja e bizneseve që tashmë ata mund të paguajnë një tarifë me mbi 30% më shumë.

Për sa i përket punonjësve të shërbimit, për hir të së vërtetës, i shoh që punojnë nëpër kanalet kulluese etj. Ndoshta përgjegjësit e tyre me gjithë respektin që kam për punën e tyre të mirë në kushte të vështira jashtë sepse kam parë që kanë edhe disa mjete pune që u shërbejnë. Pak më kujdes, domethënë, sepse qëllon ndonjëherë që i shikon që i hedhin te kanalet, te këto gropat aty, dhe kjo thjesht do t'i hapi punë një punonjësi tjetër të shërbimit që do të vijë t'i hapë pastaj për t'i pastruar këto. Ndoshta do të duan një çik më shumë kontroll, sepse ka rënë pak në sy. Mund të jetë diçka e shpejtë, ndoshta duhet parë dhe kjo punë. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit.

-Denis Pervathi: Nuk është e vërtetë për pjesën e zonave B dhe C që ka rritje 30%, sepse edhe si për zonën A, B dhe C, niveli i taksave ka qenë i njëjtë, i ndryshëm ka qenë veç për zona A, B, edhe me çka kanë ndryshuar tarifat. Kurse B me C kanë pasur ndryshime krejtësisht minimale, dhe tani janë bërë zona A, zona Lezhë, Shëngjin dhe zona 100 metra nga autostrada, që është zona e parë, kurse gjithë njësitë e tjera janë zonë B. Kurse ndryshimet midis zonës B dhe C kanë qenë krejtësisht minimale, tani janë bërë gjithë njësitë janë futur në një zonë, edhe për një lehtësi fiskale, edhe për mos të pasë shumë burokraci. Po, nuk kanë pasur ndryshim.

Tarifat e shërbimeve nuk ndikohen nga zona, ndikohen nga xhiro dhe lloji i aktivitetit. Nëse ti ke një xhiro të lartë si në Ungrej, si në Shëngjin, do të tariforesh më tepër.

-Donika Haxhia: O zotëri, më duket se fola shqip, ose ti po don me e zgjat shumë. Unë fola për tarifat, bëra një pyetje që ti fare mirë mund ta sqarosh, dhe unë e cilësova vetë, thashë a është rrit xhiroja, shumë mirë, në qoftë se xhiroja në Ungrej qenka njëlloj sa në Shëngjin që po thua ti, jam okej. Më fal, unë thashë nga tre në dy, në paketën fiskale të 2024, zonën C e kishe me 1200, ndërsa tani e ke me 1650, pra është mbi 30% në llogari.

-Ka diskutim pa mikrofon mes znj. Haxhia dhe z. Pervathi.

-Ndue Luli: T'ia japim fjalën kryetarit të komisionit.

-Agostin Marku: Në qoftë se ne do të vendosim po supozojmë për atë zonën C apo B apo A, kë të duash ti dhe të themi që për të njëjtën xhiro vendosim tarifë të ndryshme, ky është diskriminim mes bizneseve për të njëjtën xhiro. Në qoftë se themi që tarifa për rritjen e xhiros ka një tarifë më të lartë e tjera e tjera për të gjithë njëlloj, ky është barazi dhe shumë transparencë për biznesin. Sa i takon ndarjes së zonave, këto e thanë, është edhe e shkruar, çështja e tarifave nuk hyn tek abonentët familjarë, është vetëm tek bizneset dhe biznesi si në Ungrej, si në Zejmen, si në Dajç, si në mes të Lezhës, në qoftë se bën 80 milionë lek xhiro, ka të njëjtën tarifë, se ka bërë 80 milionë xhiro, si atje, si atje. Pra, këtë e përcakton mjaft mirë paketa. Ky është sqarimi. Faleminderit që më dëgjuat.

-Ndue Luli: Fjala për zonjën Gjoni.

-Flutura Gjoni: Në lidhje me taksat dhe tarifat, nga diskutimet e parafolësve mora sqarim. Te penalitetet, unë diskutova dhe dje në komision me drejtorin. Kisha nja dy pika, unë pika B1 dhe B2 janë ndarë, por për mendimin tim janë kot të ndara, sepse nuk ndryshon norma. Për mua do të jenë dhe një pikë, edhe për familjarë, edhe për biznesin është e njëjta masë. Edhe këtu te pika 3 -

E vitit tjetër shfuqizohet, thotë, ndërsa kjo tjetra hyn në fuqi në janar 2026. Këtë muaj nuk kena fare në fuqi asnjë. Duhet të rregullohet për mendimin tim. Pjesa tjetër jam okej.

-Ndue Luli: Fjalën zonja Marku.

-Alfrida Marku: Faleminderit. Atëherë, sa i përket paketës fiskale, unë e mora përgjigjen se cila është arsyeja e rritjes së tarifës së shërbimeve publike për kategorinë e bizneseve të supërcituara. Unë kam një pyetje: sa mendoni ju, sa keni parashikuar se kjo rritje e tarifës së shërbimeve publike vjen si rezultat i një rikonceptimi të mënyrës së menaxhimit të mbetjeve, më lejoni të them që unë mendoj se me zërin buxhetor që Bashkia Lezhë kishte në dispozicion për të likuiduar operatorët e pastrimit të mjedisit, do të ishte i mjaftueshëm për të menaxhuar edhe mënyrën e re të menaxhimit, për të menaxhuar edhe mënyrën e re të rikonceptuar nga ana juaj për mbetjet. Së dyti, unë gjithmonë kam besuar se forca kryesore e përfaqësimit është të argumentosh mendimin ndryshe, por nga ana tjetër edhe të propozosh bazuar në atë çfarë ti beson. Edhe në këtë drejtim unë jam munduar gjithmonë që të jem e vëmendshme sa i përket problemeve të qytetarëve dhe t'i adresoj tek ju si institucion në formën e propozimeve për t'u përfshirë pse jo në paketën fiskale apo edhe në buxhetin të cilin presim ta diskutojmë në dhjetor. Në lidhje me paketën fiskale, unë kam adresuar zyrtarisht tek ju disa propozime të cilat, në fakt, minimalisht në respekt të këshillit bashkiak dhe të qytetarëve, kam pritur nga ana juaj një argumentim se pse nuk janë marrë në konsideratë. Minimalisht duam por s'mundemi, apo mundemi por s'duam. Kam propozuar përjashtimin nga detyrimet vendore të grave në nevojë, kryefamiljare, sidomos ato që ndjekin arsimin e lartë apo profesional.

-Pjerin Ndreu: Janë përjashtuar. Të gjitha familjet në nevojë.

-Alfrida Marku: Jo të gjitha.

Atëherë, grave, unë e thashë më gjatë fjalinë, grave kryefamiljare, përveç atyre që ndjekin arsimin e lartë apo arsimin profesional, si një mënyrë e mirë për t'i motivuar ato drejt arsimimit dhe një mënyrë dinjitoze për t'i fuqizuar ekonomikisht. Kam propozuar gjetjen e një mënyre nga ana juaj për rimbursimin e biletës për transportin publik për të gjithë pensionistët. Ju e keni parashikuar disi, por nuk i keni dhënë zgjidhje përfundimtare. E keni lënë në vullnetin e operatorëve të transportit publik. Pra, nëse subjekti rimbursion biletën për pensionistin, do të jetë i përjashtuar nga tarifat e shërbimeve publike. Pra, e lini fakultative në dorë të subjekteve të transportit publik dhe nuk e bëni prerogative apo të detyrueshme. Pra, ju si institucion duhet t'ua impononi apo ta vendosni si rregull rimbursimin e biletës për pensionistët. Është një mënyrë e mirë. Pra, një biletë e rimbursuar është një vizitë më shumë për pensionistin, është një ditë pazari më shumë për pensionistin, pse jo, është edhe një vajtje tek qendra e moshës së tretë, të cilën e presim shpejt ta nisim në qytet. Pra, pse t'i penalizojmë pensionistët e zonave rurale për të udhëtuar në qendër? Kam propozuar gjithashtu që të parashikohet në paketën fiskale një detaj i tillë sa i përket dhënies në përdorim të pronës publike bizneseve, që krahas detyrimeve të parashikuara në ligj, të shoqërohet dhe me detyrimin e kryerjes së shërbimeve apo investimeve nga këto subjekte në shërbim të komunitetit. Vlera e shërbimit apo e investimit, të jetë në raport të arsyeshëm me kapacitetin financiar të sipërmarrjes, planin e biznesit dhe të ardhurat e gjeneruara nga ky biznes, pikërisht si rezultat i përdorimit të kësaj prone publike, dhe në çdo rast jo më pak se 10% e fitimit vjetor. Kam propozuar gjithashtu edhe përjashtimin nga tarifat vendore për një masë lehtësuese për të rinjtë që drejtojnë biznese. Unë mendoj, po e përsëris, që

minimalisht nga ana e drejtorisë së taksave do të duhej një përgjigje, sepse në fund të fundit ky është edhe thelbi i konsultimeve publike. Pra, ne zhvillojmë konsultime publike jo për të prezantuar draftin final të paketës fiskale, por për të marrë mendime, propozime me qëllim që t'i përfshijmë në paketën fiskale bazuar në nevojat e qytetarëve. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Zoti kryetar.

-Pjerin Ndreu: Ne e mirëkuptojmë çdo lloj propozimi që bëhet dhe ka interes për ta bërë. Nuk jemi kundra. Por jo çdo propozim merret parasysh. Kjo nuk do të thotë se domosdoshmërisht dikush duhet të propozojë dhe domosdoshmërisht do ta marrim parasysh. Pra, mbajmë një qasje tonën. Paketa fiskale është ndërtuar aty, është nxjerrë në treg për t'u diskutuar, në 90%, mos më shumë, diskutimi ka qenë okej edhe me biznesin, që na lë ne me kuptu se jemi në paketën fiskale të duhur. Unë jam dakord për pensionistët, sidomos në rastin e pensionistëve, ne e kemi lënë një hapësirë, për momentin ua kemi lënë me përfitim. Nëse e rimbursojnë, ne nuk i tërheqim. Po, fakultative, po aty e kanë atë lekun, atë të njëjtën gjë. Mirëpo, ne jemi duke bërë një plan transporti dhe buxheti që do të vijë, do të vijë një zë që ne investojmë për një plan transporti dhe investojmë planin, jo transport, por investojmë planin fillimisht. Na duhet një plan nga ekspertë të njohur me detaje që ne, kur të dalim edhe për biletën nesër, edhe për mënyrën si do të bëhet me shtresat në nevojë, edhe për të gjithë kohën e plazhit. Do ta adresojmë edhe për zonat e plazhit atje që nuk do të paguajnë asnjë lek në Shëngjin. Pra, do ta dizajnojmë që sot edhe mënyrën se si mund të hyjnë këto që janë me zhvillime me problematikë, të pamundur. Pra, nuk është se ne nuk e kemi plan, por janë disa gjëra që duhet të bëhen me këmbë në tokë dhe të studiara dhe vijnë paralel me planin e transportit. Për momentin, i kemi lënë këtë hapësirë dhe nuk kemi një zgjidhje si me thënë teknike që mund ta bëjmë. Ne do ta bëjmë. Pastaj duhet një evidentim i saktë i gjësë. Pra, këto shtresat në nevojë janë të përjashtuara, ndërsa kur vjen puna te pensionistët, në rastin e rimbursimit të biletës, unë jam dakord që ta bëjmë, por s'e besoj të na vonojë shumë vitin tjetër, brenda katër muajve të parë ne do ta kemi adresuar planin e transportit. Ne do ta adresojmë planin e transportit dhe unë jam i parimit dhe s'ka gjë për të fshehur këtu që ne linjat t'i nxjerrim në ankand dhe me ankand me kriteret që duam ne. Hajde merre linjën ti me ankand, por do të kesh autobuza t, të këtij viti, do të kesh këtë çmim bilete, këto stacione. Plus që ne me SMARTLAND-in marrim një autobus vetë në bashki dhe mund ta vëmë në dispozicion të moshës së tretë, edhe për rastet e pushimeve, për rastet e ekskursioneve, për rastet e ndryshme. Pra, mund t'ia vëmë në dispozicion. Ose ne mund të lëmë një linjë të dedikuar, për shembull, në autobuzat që do vijnë, që do bëjmë me planin e transportit, që një autobus të jetë vetëm për shtresat, por është pak problem me e nda dhe do gjejmë një formë këtu në këshill se si do ta bëjmë. Tashi, kjo e të rinjve nuk mund të bëhet kështu. Të rinjtë që hapin biznes, se atëherë të gjithë fillojnë e ndërrojnë, mbyllin NIPT-et, ia japin djalit biznesin, djali shkon dhe e hap, edhe ne na bie që mos të marrim taksa fare. Pra, është pak abuzuese kjo me këtë skemën. Nëse gjejmë një metodë, një mënyrë që ta mbyllim rrugën e abuzimit, po ne e kemi diskutuar. Nuk është se nuk është diskutuar kjo, nuk është se nuk është vlerësuar. Pra, është vlerësuar. Si mund t'ia bëjmë nëse një kategori të rinjsh hapin biznes për herë të parë? Ne kemi biznes që ka 15 NIPT-e, mbyll e hap, e hap e mbyll, për efekt të taksave dhe ka 4 vjet që s'pagan asnjë lek. Ka hapur një tjetër me emër tjetër. Debia është 365 milionë të reja, është borxhi që na ka ne biznesi, me këto lëvizjet e tilla. Po t'i kishim, do ishin në të tjera kushte. Ne kemi futur gratë e veja, ne i kemi përjashtuar. Tashi duhet të flasim me këmbë në tokë. Ne akoma jemi në një konsolidim financiar. Ne po vijmë drejt konsolidimit financiar. Nuk është e thjeshtë që të ruash një balancë financiare pa

shtrëngu popullatën. Niveli i shërbimit vjen natyrshëm duke u rrit. S'po ia atribuoj vetes, po vjen natyrshëm se ecën shoqëria, zhvillohet vendi, rriten kërkesat, rritet konsumi, rriten objektet që ndërtohen, sociale, kulturore, sportive, banesa, rritet gjithçka, normalisht rriten edhe kostot e shërbimeve. Dhe ne kemi kaq kohë që i mbajmë kostot e shërbimeve në nivele të pranueshme. Tashi, po të marrim zonat rurale, i bie 37 mijë lekë të vjetra në vit. Ne kemi rritur tarifën e shërbimeve funerale për arsye se na e kërkon ne ai me pastru atje, na e kërkon po s'pague asnjë lek. Atëherë do ta bëjmë ne si bashki? Po. Atëherë të paguash lekë. E unë shkoj me gjithë punonjësit dhe e bëj atje, e bëj shërbimet, e pres barin, e rregulloj çfarë mund të rrëshqasë aty, po në qoftë se ti nuk paguan fare, atëherë çfarë do bëj unë? Bëje ti me fshatin. Unë s'e bëj. Po ti s'e bën, ne jemi detyruar me ndërhy me një formë tjetër. Gradualisht ne do hyjmë, që sivjet ne do hedhim sytë për të bërë dy varreza publike, një në mes Shënkollit që të kapim të tre njësitë vendore, varrezë publike, që mos të lëmë matrapazët të shesin varre. Ose një varrezë publike ku e kemi si bashki, do paguash lekë ti, por jo 4 milionë lekë. 250 mijë që është një tarifë e pranueshme dhe ne u japim mundësi njerëzve që mos të shkojnë të abuzojnë deri te varrezat. Kjo është absurde. Ne jemi duke u mundu me e zgjidhë, po bëjmë hapin e parë, pastaj mbase do blejmë tokën. Do blejmë tokën aty dhe do bëjmë një varrezë publike, sikur po bëjmë të qytetin. Këto ditë fillon puna, është nënshkru kontrata. Do bëjmë edhe dy varreza të tjera. Janë disa refleksione që janë bërë shumë të kujdesshme këtu. Edhe njëherë po them, edhe sasia po ta marrim me menaxhimin e mbetjeve se e përmende, menaxhimi i mbetjeve është duke u rrit sasia e tonazhit për çdo vit, është rrit edhe te landfilli atje. Pra, çmimi i landfillit nuk është më ai i para katër viteve, është rrit dy herë. E normalisht janë rritur edhe kostot. Mos të harrojmë se nëse ne do hyjmë në një variant të ri, fillimisht do të disponohemi edhe me blerjen e gjithë sistemit të ri të koshave të mbeturinave. Ne nuk mund të rrimë me këtë sistemin që kemi sot. E dyta, ne duhet të bëjmë fushatën sensibilizuese, duhet të mobilizojmë njerëzit që të kuptojnë se çfarë do të bëjmë. Ka kostot e veta dhe ajo, dhe ne duhet ta bëjmë, por ajo është me përfitim për ne. E treta, duhet t'i vëmë fre abuzimit të disa bizneseve që nuk lënë gjë pa bërë me ndotjen e mjedisit. Të gjithë bizneset do mbajnë kosh. Do vijë me orar makina dhe do ta nxjerrësh aty. Pse? A jeton aty? Ne jemi duke u mundu me rregullu diçka që i shërben njerëzve, jo që më shërben mua. Do vëmë kamera në qytet. Komplet qyteti do bëhet me kamera, edhe për çështje të sigurisë, se do vijë buxheti dhe do i shpjegojmë. Do marrim dhe kamera të lëvizshme. Nuk ka rrugë tjetër. Normalisht ka kosto, ka rritë kostot. Ama këta që bëjnë zullume përditë, do paguajnë më shumë dhe pikë. Nuk diskutohet.

-Ndue Luli: Faleminderit. Fjalën e ka zoti Ndreca.

-Ndërhyn zonja Gjoni në lidhje me atë që tha për hyrjen në fuqi dhe merr përgjigje që nnuk ka vakum nga paketa e mëparshme në të renë.

-Erin Ndreca: Përsëndetje. Po e nis nga fundi. Kjo çështje është teknike juridike, mendoj që u përket specialistëve, mendoj që qytetarët duhet të jenë të qartë, por edhe ata nuk është se kuptojnë më shumë këto gjëra në kuptimin juridik. Prandaj që do ishte mirë të diskutohej dhe në komisione për këto çështje teknike. Doja ta nisja tek paketa që të bëjmë diçka të qartë. Janë të vlefshme të gjitha diskutimet, ia vlen të diskutojmë çdo detaj, por duhet të kemi parasysh që nuk jetojmë në vende me standarde siç kemi vendet si Suedia dhe Danimarka. Jo që të na mungojnë pretendimet, por që t'i shohim gjërat që në themel. Kemi një konsolidim të të ardhurave, kemi një konsolidim të buxhetit, jemi një vend, jemi një bashki që kemi nevoja, po themi, që në themel. Kemi nevojë që të kemi infrastrukturë rrugore, kemi nevojë që të kemi infrastruktura më të

rëndësishme, arsimore, shëndetësore. Jam shumë dakord që të mendojmë për të rinjtë, jam shumë dakord që të mendojmë për gratë në nevojë, por mendoj që administrata e bashkisë dhe gjithë institucioni i bashkisë ka treguar që që nga ardhja dhe deri tani ka një qasje për të avancuar në themel, për t'i marrë gjërat nga fillimi. Tani, për t'i marrë gjërat nga fillimi, i bie që të vazhdojmë të këto gjërat elementare, sepse janë këto gjërat elementare që çojnë dhe tek ajo që u tha, tek ndërgjegjësimi. Nëse ne dërgojmë një rrugë në një fshat, patjetër që në atë zonë rritet mirëqenia, patjetër që në atë zonë vazhdojnë të paguajnë më shumë, patjetër që pastaj me rritjen e pagesave dhe rritjen e të ardhurave, patjetër që kemi mundësi pastaj të shkojmë me këto të tjerët. Tani, na vjen një relacion i cili i shpjegon më së miri gjërat. Na tregon çfarë mbetet pa ndryshuar dhe na tregon çfarë ndryshon. Kur vjen puna, të gjithë themi pse këta biznese që ndotin më shumë nuk tarifohen më shumë. Tani na paraqitet dhe themi, nuk themi një bravo që po tarifohet diçka më tepër, e cila është edhe e argumentuar, nuk është diçka që është ëoë, pse u rrit kaq shumë. Por dalim dhe kërkojmë atë që s'është. Thjesht për të thënë diçka. Prandaj mendoj që shumë mirë janë paraqitur gjërat. Ata që do të fitojnë më tepër, që kanë një biznes, do tarifohen më tepër. Pjesa e qytetarëve familjarë janë të paprekur. Një bashki e cila nuk ka të ardhura, nuk shpik lekë. Lekët do i marrë tek të ardhurat, te tarifat dhe taksat. Tarifat dhe taksat deri tani kanë treguar që kemi një rritje buxheti. Kjo rritje buxheti është përkthyer në projekte. Rritja e projekteve do sjellë ndërgjegjësim për të rritur të ardhurat dhe pagesat. Prandaj nuk shikoj që ne me patjetër të kapemi pse unë thashë këtë, pse unë thashë atë. Unë mendoj që kjo duhet të bëhet, unë mendoj që ajo duhet. Mendoj që ka një pasqyrë shumë të qartë për nevojat më themelore për t'u zhvilluar një bashki, për t'u zhvilluar një vend. Prandaj ju lutem të përqendrohemi tek gjërat thelbësore dhe ta kalojmë në votim dhe ju ftoj ta votojmë. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Ka kush ndonjë shtesë? Po zoti Kosova.

-Soveljan Kosova: Problematika e cila u ngrit nga disa nga kolegët e mi lidhur me rritjen e disa tarifave për disa fasha, realisht, mendoj dhe argumentoj se duhet të ishte shtyrë. Nuk është një vit ku mund të rritet dhe duhet domosdoshmërisht të rritet. Në qoftë se marrim parasysh ose shohim, një motor i kësaj shoqërie që na sjell lekë, që na sjell taksa, që sjell punësim, që sjell aktivitet, është kjo fasha që ne në Shqipëri e quajmë e mesme, por që është fasha e bizneseve të vogla. Nuk besoj se duhet të trajtoheshin të gjithë, sepse disa abuzojnë në mes të qytetit, disa abuzojnë aty në Shëngjin për shkak të mbetjeve që sjellin. Kjo, sipas mendimit tim, ka kërkuar që të krijohet një klimë sensibilizimi paraprakisht, ndërkohë që do kalojmë edhe tek një metodë tjetër e heqjes së mbetjeve, apo trajtimit, apo e pastrimit të qytetit. Besoj se është e parakohshme dhe vitin tjetër do të themi pse s'u rritën. Ky është mendimi për ndryshimin e këtyre tarifave, realisht. Ndërkohë që për pjesën e futjes së shërbimit për varrezat është pak i vonuar, por megjithatë shërbimi pas saj është realisht për t'u monitoruar. Ndërkohë që njerëzit vetë, komunitetet nuk funksionojnë mirë, realisht kjo është punë që duhet monitoruar sistematikisht. Kaq kisha.

-Ndue Luli: Faleminderit. Diçka para se ta hedhim në votim.

Po z. Kryetar.

-Pjerin Ndreu: Kjo nuk është ndonjë barrë në kuptimin e taksave, kjo është barrë në kuptimin e tarifave. Tarifat janë për arsye të një sistemi që është ndotësi më i madh dhe nuk është ndonjë barrë e madhe. Për shembull, nga 80 shkon 100. Për shumicën është një rritje 20%, 15%. Pra, varet nga tipologjia. Ne po bëjmë një investim për të rritë cilësinë e jetesës, pra edhe për të

mbuluar kostot, sepse këta janë prodhuesit më të mëdhenj të ndotjeve. Është paraparë, bile jo janë prodhuesit, por po t'i marrësh të gjitha këta, asnjëri nga elementet që prodhojnë, as alumini, as materialet e ndërtimit, as mishi as peshku, nuk shkojnë në landfill. Dakord? Është një problem tjetër me të cilin do përballemi ne, që një pjesë do e adresojmë duke e bërë fushatën sensibilizuese. Dhe ne i kemi kërku qeverisë që të rrisin penalitete për ta. Dhe tipologjinë e koshave që do marrim ne, do të jetë tipologji koshash me dritare, që nuk mund të futësh thesin si të duash ti, por mund të futësh vetëm ato që janë të riciklueshme. Janë ndotës, janë të evidentuar, nuk është një numër i madh biznesesh që afektohen, por është një grup biznesesh që duhet të tregojnë kujdes. Në Ishull kemi kapur të tillë biznese që e bënin rrëmujë. Aty në Ishull, unë jam ulur disa herë dhe kam thënë: "Ore, çfarë ndodh këtu? Ka luftë mendsh mileti në Ishull, në fakt ata ishin në rregull. Ishin të gjithë këta ndërtues, ushqimore, fruta perime, me furgona, me makina, merr thesin, e hidh aty." Edhe i hidhnin poshtë, as në kosh jo. Kjo është logjike, është e testuar, është në bazë të asaj që ne kemi marrë si feedback nga terreni dhe e fundit, ne kemi bërë konsultim publik me bizneset. Kanë marrë pjesë shumë biznese, nuk është se na kanë ngritur ndonjë shqetësim për këtë.

-Ndue Luli: Faleminderit, kryetar. Ajo që doja të shtej unë, shumë shkurt, një fjali ishte kjo që e mbyllët ju. Në dëgjuesën publike me bizneset, është mirëpritur, biles ka pasur nga ata që kanë biznese dhe kanë thënë që është diçka simbolike, biles ajo rritje.

Atëherë, kush është dakord me projektvendimin? Ju lutem, kartonat. Miratohet me 29 vota PRO. Këshilltarët Sovëljan Kosova, Donika Haxhia, Donika Ndoj, Emanuel Përkaku votuan Kundra, 4 vota Kundra. Këshilltarja Alfrida Marku votoi Abstenim, 1 votë Abstenim. Faleminderit.

Vazhdojmë me pikën 3 të rendit të ditës, Projekt-vendim "Për një shtesë në vendimin nr. 74, datë 25.09.2024 "Për miratimin e pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë, të punonjësve administrativë, të punonjësve mbështetës dhe të masës së shpërblimit mujor të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave" i ndryshuar"

Kush e do fjalën në lidhje me projektvendimin? Ka ndonjë diçka? Nuk ka. Kush është dakord me projektvendimin? Ju lutem, kartonat. Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 34 vota PRO. Faleminderit.

Kalojmë te pika 4, Projekt-vendim "Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr. 99, datë 19.12.2024 "Për miratimin e PBA-së 2025-2027 dhe Buxhetit të vitit 2025".

Në lidhje me projektvendimin ka kush diskutim? Nuk ka. Kush është dakord? Ju lutem, kartonat. Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 34 vota PRO. Faleminderit.

Kalojmë te pika 5, Projekt-vendim "Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi të bashkisë, për kryerjen e aktivitetit minerar në objektin Gjombardhaj nga shoqëria "Gjoni" shpk".

Për këtë ka funksionuar shumë mirë edhe komisioni i djeshëm. Fjalën e ka kryetari i komisionit përpara.

-Dod Jaku: Përsëritje të gjithëve. Komisioni i bujqësisë i mbledhur ditën e djeshme, pasi morin në analizë këtë projektvendim, në bazë diskutimeve që pati, me shumicë votash në komision, doli me vendimin që t'i propozojë Këshillit Bashkiak që ta miratojë këtë projektvendim për dhënien e dakordësisë të heqjes nga fondi pyjor të një sipërfaqe prej 6.7

hektarësh në zonën e Kashjetit, Gjobardhaj. Tani, në lidhje me këtë, problemet janë të ndryshme. Ne do t'i japim vetëm dakordësinë si Këshill Bashkiak, sepse janë dhe procedura të tjera që subjekti do të kryejë dhe janë institucione të tjera që japin verdiktin përfundimtar.

Unë i ftoj kolegët ta miratojmë këtë projektvendim, duke pasur parasysh që edhe zhvillimi i një aktiviteti në një zonë rurale tepër të thellë dhe punësimi i disa njerëzve atje sjell përfitimet e tija, edhe në bazë të disa pasqyrave financiare që janë paraqitur dhe tregojnë që biznesi është një biznes i shëndetshëm dhe i bëhet mirë komunitetit, bashkisë dhe të gjithëve. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Kush e do fjalën? Zonja Marku.

-Alfrida Marku: Faleminderit. E konsideroj të arsyeshme që të sqaroj qëndrimin tim, sa kohë jam edhe pjesë e Komisionit të Bujqësisë. Unë, në fakt, për herë të dytë radhazi në Komisionin e Bujqësisë, kam kërkuar që Bashkia Lezhë ta trajtojë në mënyrë më të arsyeshme këtë projektvendim, këtë iniciativë, që krahas hapjes rrugë të këtij subjekti për përdorimin e pronës publike, njëkohësisht vendos kushte në dakordësi me subjektin që ky i fundit të kryejë investime në infrastrukturë, në shërbim të zonës, bazuar, kuptohet, në pjesën takuese të fitimit vjetor, që vjen drejtpërdrejt si rezultat i përdorimit të kësaj sipërfaqeje të pronës publike. E kam shprehur edhe më herët se, midis së drejtës së subjekteve private për të kërkuar përdorimin e pronës publike dhe të drejtës së qytetarëve për të marrë në këmbim të mira dhe investime nga përdorimi i kësaj prone publike, duhet të ruajmë një proporcionalitet të drejtë dhe të arsyeshëm. Në rastet kur e parashikon ligji, ne po, duhet t'i hapim rrugët përdorimit të pronës publike nga subjektet, por siç e thashë edhe më lart, me kushtin e arsyeshëm që këto të fundit të kryejnë investime në zonën përkatëse, në infrastrukturë, në rastin konkret në Ungrej. E kundërta do të sillte jo përdorimin e pronës publike, por shfrytëzimin e pronës publike, duke mohuar interesin publik. Edhe kuptohet, interesi publik, edhe me kushtetutë, ka tjetër trajtim krahasuar me interesin privat. Përdorimi i pronës publike nga subjekte private nuk duhet të kufizohet vetëm në pagesën e detyrimeve vendore, por, siç e thashë, edhe në kryerjen e shërbimeve apo investimeve në shërbim të komunitetit. Unë po jap dy shembuj: një të Bashkisë Lezhë dhe një të Bashkisë Mirditë, ku kam marrë unë indicien, pra. Dhe jo pa shkak këtë logjikë e kam propozuar që të përfshihet edhe në paketën fiskale. Ta bëjmë rregull ne, nëse një biznes apo grup biznesesh përdorin pronën publike, ata nuk duhet të kufizohen vetëm në pagesën e taksave dhe tarifave përkatëse, por duhet të kryejnë edhe shërbime dhe investime në zonën përkatëse për komunitetin. Po ilustroj me dy shembuj. Para disa viteve, dy-tre vite, mos gabo, një grup biznesesh në zonën e Shëngjinit, me kontribut vullnetar, ndërtuan trotuarin në zonën e Kunes. Shumë e kundërshtuan, e anatantuan e konsideruan shfrytëzim. Personalisht, e kam mbështet në atë kohë dhe kërkoj që të ndiqet si shembull edhe në vijim. Nga ana tjetër, në bashkinë e Mirditës, për analogji, një subjekt privat ndërton HEC-e në zonën e Kaçinarit dhe Bashkia e Mirditës, në mënyrë të arsyeshme, i vendos kusht Shpërdhaza shpk, në mos gabo, që dakord, unë po të lejoj, po të hap rrugë që ti të ndërtosh hidrocentrale, pra të zhvillosh sipërmarrjen tënde, por njëkohësisht duhet të kryesh investime në zonën e Kaçinarit në infrastrukturë në vlerën jo më pak se 2 miliardë lekë. Pra, po jap këto dy shembuj për të argumentuar qëndrimin tim në komision. Nuk jam kundër që subjektit përkatës t'i jepen 67 mijë metra katrorë sipërfaqe pyjore, por absolutisht ne duhet t'i hapim rrugë një rregulli të ri, që cili do qoftë ai subjekt, nëse përdor pronën publike, krahas pagesës së taksave dhe tarifave vendore, duhet të kontribuojë edhe për kryerjen e investimeve apo shërbimeve në komunitet. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Fjalën e ka kryetari.

-Pjerin Ndreu: Mirë, tani më duhet me e thënë se jam dakord. Unë jam dakord ta vendosim edhe në paketë fiskale. Në fakt, edhe Lezha ka një përvojë, përvoja vjen prej kohës kur ju keni qenë, fabrika e çimentos që bën investim çdo vit. Është, s'ke nevojë me shku deri në Mirditë, Pra, ne mund ta bëjmë. Jam dakord që ta fusim në paketë fiskale, që edhe bizneset e tjera, se kjo, për shembull, nuk është në sipërmarrjen e atyre përmasave. A kupton? Megjithatë, unë jam dakord që në paketën fiskale, meqë t'i rikthehem mbrapsht dhe të fusim një përqindje, 1% ose 2% të fitimit, apo investimit, apo ku di unë se si mund ta rregullojmë, të kalojë në shërbim të atij komuniteti në kuptimin e riparimit të shkollës, të çerdhes, të rrugës, apo të ndonjë problemi atje, unë jam plotësisht dakord. Faleminderit.

-Ndue Luli: Fjalën e ka zoti Jaku.

-Dod Jaku: Jo se nuk jam dakord parimisht, por do të shikojmë rrugën ligjore të saj, t'i përmbahemi ligjit, se pastaj do fillojmë të shtrëngojmë bizneset, edhe t'i themi jo, në qoftë se nuk më bën këtë, nuk e ke këtë.

-Pjerin Ndreu: Mundemi t'i vendosim, sepse impakti mjedisor që kryen një aktivitet iks atje është shumë i madh. Prona, nga ana tjetër, është publike, i merret përqindje në raport me fitimin.

-Dod Jaku: Unë jo se nuk du që edhe biznesi të kontribuojë, po du që edhe bizneset mos ta shikojnë si gogol në kuptimin e fjalës se ai ka vështirësitë e veta.

-Ndue Luli: Fjalën e ka zoti Artan.

-Artan Ndreu: Jo, kisha një pyetje, pastaj diskutim. Çfarë letre, çfarë dokumenti është shtu, pse e anullem herën tjetër?

-Ndue Luli: Besoj se keni relacion për pasqyrat financiare. Fjalën e ka nënkryetari i bashkisë.

-Fatjon Zefi: Artan, herën tjetër nuk u votua, sepse edhe vetë komisioni ishte i paqartë. Pika tre e vendimit pa hyrë te relacioni, thotë, rehabilitimi i sipërfaqes pyjore të dëmtuar jashtë pjesës ku kryhet aktiviteti, pra shoqëria do të rehabilitojë një sipërfaqe të njëjtë, do të bëjë pagesë, do të paguajë edhe për projektin, edhe investimin. Pra, shoqëria do ta bëjë kompensimin ndaj bashkisë. E para. E dyta, fondi pyjor nuk ekziston më. Shoqëria ka që në vitin 2022 që ushtron aktivitetin me leje minerale të dhënë nga Ministria e Energjitikës. Pra, ne sot thjesht jemi tu i hap rrugë për të na bërë kompensimin. Pra, ne si e votuam, si s'e votuam, ai e vazhdon aktivitetin.

-Pjerin Ndreu: Ka mundësi të bëjmë një argument. Ne si bashki, na është dhënë nga qeveria fondi pyjor. Tani jemi përballë dy problemeve që ne të gjithë bashkë sa jemi këtu, duhet t'i adresojmë, jo vetëm ne si staf bashkie, por gjithsecili prej këshilltarëve duhet të punojë në zona që këto zona pyjore të administrohen. Të administrohen në proces ku edhe ne marrim taksa, edhe dikush i shfrytëzon për një arsye X në bazë të ligjit. Pra, ne nuk kemi pse të tregohemi kështu të ngurtë dhe të themi: "Obobo, obobo." Për sa kohë ka një aktivitet ligjor, që paguan taksat dhe ne na gjeneron të ardhurat, ne pse mos ta bëjmë? Ne kemi një situatë. Nga ish-komunat janë dhënë sipërfaqe pyjore në përdorim ndër vite, ka mbaruar afati i këtyre dhe akoma i kanë në përdorim. Njëri ka shkuar e ka mbjellë vreshtë, tjetri ka shkuar e ka mbjellë ullinj, tjetri ka shku ka bërë ça ka deshë me fondin pyjor. Dhe unë kam ulur stafin dhe kam thënë: "Më jepni një informacion të saktë cilën do rikuperojmë, për shkak se nuk ka dalë nga objekti, cilit do ia heqim se ka dalë nga

objekti, cilit do t'ia japim që është një projekt i ri." Secili prej jush mund të paraqesë një projekt nëpërmjet njerëzve në zonën tuaj aty dhe mund t'ia japim. Çfarë problemi ka? Ne nuk e administrojmë dot të gjithë sipërfaqen pyjore. Atëherë e mbajnë të tjerët, pse mos ta mbajmë? Edhe ata kanë përfitimet e veta, edhe ne si bashki kemi përfitimet tona. Nuk duhet të jemi të ngurtë në këtë punë. Pse duhet të jemi të ngurtë? Duhet t'i stimulojmë biles që të lëvizin. Ka kaluar afati 10-vjeçar, janë zhbërë të gjitha ato që janë dhënë fonde pyjore në përdorim. Komplet janë në zero tashmë. Do ti të vazhdash? Më jep planin e biznesit se çfarë do bësh ti, se si do e bësh. Dhe ne në këshill do vimë.

-Ndue Luli: Atëherë fjalën e ka zoti Artan.

-Artan Ndreu: Po, zoti kryetar i këshillit. S'e pata në plan fare me fol por marr shkas nga ca njerëz, këshilltarë, që marrin përsipër ca gjana që unë nuk i kuptoj. Përgatiten gjatë gjithë javës me diskutu. Në lidhje me çështjen e kësaj pronës, unë jam shumë dakord që t'i jepet prioritet zhvillimit. Dhe marrin guximin ca këshilltarë dhe thonë: "Hajde më tako mua nqs do me e kalu në këshill." Ju lutem shumë, kanë filluar të shkrujnë emra rrugësh, emra personale, emra privatë. Ju lutem shumë, jo emra privat, ku të mundni e si të mundni.

-Ndue Luli: Tek "Të ndryshme" këto. Faleminderit Artan. Atëherë fjalën e ka nënkryetari.

-Agostin Marku: Unë marr shkas nga zhvillimi që mori kjo pjesë. Jam shumë dakord që ajo shtyrja nga mbledhja tjetër duhej të justifikohet sot me ato veprime që është shty. Është shty për me sa di unë edhe me sa kam diskutuar për një qëllim të vetëm, vetëm e vetëm që kompanisë t'i saktësohet ajo pjesë që duhet të kontribuojë për zonën. Nuk jam kurrë dakord që fondet pyjore t'i japim që të fitojë biznesi, por të ndryshojmë destinacionin e pyjeve, se në fund të fundit ato pyje janë për rregullimin ekologjik dhe ne do ta ruajmë dhe do të jena shumë fanatikë në këtë çështje. Do të isha dhe inkurajoj bashkinë dhe kryetarin e bashkisë dhe për mua janë pak të vonuar që të rishikojmë të gjithë ato paçavure që kanë dhënë komunat të marrë prona e ku ta di unë njerëz që nuk i takojnë në fakt e s'kanë qenë dhe nuk janë as banorë të asaj zone dhe të cilat janë tjetërsuar deri edhe në mbjellje droge e ku ta di unë në vite të ndryshme dhe të gjitha këto do t'i marrë në dorë bashkia, do t'i saktësojë, do t'i ligjërojë edhe e mbështes edhe zonjën Frida, sa i takon me biznesin, ne do të jemi shumë transparent me to, por duhet që të vendosen edhe rregulla loje, sepse në fund të fundit biznesi nuk e ka marrë që të përmirësojë atë fondin pyjor, por është duke e marrë për qëllime fitimi. Dhe kur e merr për qëllime fitimi, të fitojë edhe komuniteti, të fitojë zona, të fitojë Bashkia e Lezhës. Në qoftë se do t'i bëjmë kështu, s'do të kemi asnjë lloj keqkuptimi në këtë drejtim. Uroj që bashkia ta ketë marrë seriozisht dhe atë padrejtësi që është bërë në vite me paçavure, me pilafe, ku ta di unë, nga ato këshilla komunale anonim, ta ligjërojë, ta drejtojë edhe ta sjellë aty ku duhet. Faleminderit.

-Pjerin Ndreu: Një propozim. (I drejtohet zonjës Marku) Brikena bashkë me yt hartoni një draft për këtë problem, se si mund të bëhet ndryshimi në paketën fiskale, e bëjmë herën tjetër, çfarë problemi ka? Dakordësohuni si mund ta bëjmë. Unë jam dakord që të bëjmë një tip tarife që ta paguajnë në raport me investimin që bëjnë dhe dëmin që i shkaktojnë mjedisit.

-Ndue Luli: A ka ndonjë diskutim tjetër? Zoti Kosova.

-Soveljan Kosova: Në lidhje me diskutimin, përmendim një fond pyjor për një biznes të tillë që është gurore, besoj se duhet serioziteti edhe pak më i lartë sesa po e trajtojmë këtu. Jo një letër, jo dy letra, jo ça kishte, jo ça s'kishte. Unë realisht personalisht nuk jam fare kundër që zonat të

zhvillohen, pjesa publike aty ku është e mundur të jetë për biznes, por duhet të kemi parasysh vetëm diçka. Unë jetoj 10 km prej këtu, e kaloj në një rrugë ku çdo ditë punojnë disa gurore, një fabrikë, një tjetër. Kanë punuar vazhdimisht edhe po të kalosh çdo ditë aty siç kaloj unë, minimalisht ajo gurorja që është në punë, vetëm dëmi që më sjell mu personalisht që kaloj aty është jashtëzakonisht i lartë. Kjo nuk është pjesë personale e argumentimit, por kjo është një analizë që unë i bëj edhe jua sjell ju si institucion në vëmendje. Askush nuk i kontrollon se sa ndotin, se sa baltë sjellin, se sa dëme sjellin në mjedis. Askush. Besoj këtu ka njerëz që kalojnë shpesh, jo që e dinë shumë mirë problematikën, por vetëm për këtë arsye, duke patur gërmalla të disa guroreve që kanë ekzistuar më parë që vazhdojnë të jenë pjesë e jetës tonë aty, domethënë, unë personalisht nuk jam pro për këtë. Edhe pse për subjektin mund ta kem një detyrim personal, absolutisht vetëm për këtë arsye, sepse janë të keqmenaxhume, edhe sot e kësaj dite sjell problematika në komunitet. Nuk besoj se do të jetë ndryshe edhe ajo atje, megjithëse është në një zonë ku jeta, popullata është pak më e qetë, por duhet ta kenë parasysh. Këto vetëm sjellin problematika realisht.

-Ndue Luli: Faleminderit. Po zoti kryetar.

-Pjerin Ndreu: Unë jam dakord me logjikën. E para e punës ne nuk mund ta bllokojmë si biznes për shkak se kjo është absurde me e mendu. Problemi është pastaj se çfarë masash marrim ne për të parandaluar veprimet e tjera.

Unë jam dakord që kur diskutojmë paketën fiskale, ne mund të rrisim tarifat e taksat këtyre lloj bizneseve, po jam dakord, t'i detyrojmë që të marrin disa masa të tjera, shitesë, që ne mund t'i draftojmë dhe mund t'i bëjmë. Pse jo? Pra, unë mendoj se çështja e një administrate dhe çështja e këshillit janë e njëjta gjë. Këshilli, në fund të fundit, nuk ka ndonjë pengesë që të mbledhet një grup këshilltarësh bashkë me stafin, të ulen dhe të propozojë një draft X, një projekt vendim, me të cilin ne mundemi të ndihmohemi. Pse jo? Madje edhe këta që na i kanë lënë si varreza në rrugën e Shëngjinit, duhet të paguajnë një taksë, ose duhet t'ia japë bashkisë në përdorim për ta bërë venddepozitimi inertesh. Se ajo duhet të mbushet, se ashtu si është, nuk është mirë. As në kuptimin e turizmit, as në kuptimin viziv, as në kuptimin mjedisor. Jam dakord që të hyjmë, t'i shtrëngojmë. Ose të lidhë kontratë me subjektet private që t'i sjellin inertet e t'i depozitojnë aty. Çfarë problemi ka? Jam dakord. Nuk kam asnjë vërejtje për atë. I kam parë. Më dhemb koka kur i shoh. Jam plotësisht dakord. Hajde ulemi ta gjejmë mënyrën, draftin se si ta adresojmë. S'kam asnjë lloj emocioni fare, për asnjërin. Ne duhet të forcojmë mekanizmat e kontrollit.

Këshilli merr iniciativën për të thirrur institucionin përkatës për të raportuar për çështjet mjedisore që na shqetësojnë ne si komunitet. Zotëri, ka një, dy, tre çështje mjedisore, vjen ai këtu, është i detyruar me ardh në këshill, me të dhënë shpjegime një për një. Sepse nuk është vetëm bashkia që i luan këto mekanizma. Janë edhe institucione të tjera që implikohen në këtë punë, që dalin jashtë nesh dhe që janë të papërgjegjshme.

-Ndue Luli: Fjalën e ka Përgjegjësi i Pyjeve Artani.

-Artan Palushi: Përshëndetje të gjithëve. Unë doja të them një sqarim të shkurtër, besoj se do të bëj për të gjithë auditorin, në lidhje me atë çfarë po bën kryetari i bashkisë për dhënien në përdorim nga ish-komunat. Tani, në rastin e Zejmenit kryesisht, kemi të bëjmë për një dhënie në përdorim që është kryer pa akte ligjore. Në fakt, aty ka ndodhur një ndryshim katastral i zërit pyjor, që nga formacioni pyjor shkurre është kthyer në ullishte, dhe kjo është e parregulluar me

letra siç duhet. Ne kemi ngritur një grup pune në nivel drejtorie, domethënë dy sektorë, sektori i menaxhimit me sektorin e inspektimit, dhe po vijojmë kontrollet për të gjithë personat që e kanë marrë në përdorim, për të pasqyruar gjendjen reale, domethënë kush ka bërë ndryshime dhe kush nuk ka bërë ndryshime. Ato që kanë bërë ndryshime, normalisht do të vihen përpara përgjegjësisë, sepse s'kanë patur të drejtë ta ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit. Në këtë rast, unë gjykoj që e gjithë sipërfaqja që është ndryshuar, duhet të gjejnë një klauzolë ligjore që t'i kërkojmë organeve qendrore që kjo të hiqet nga fundi pyjor, për arsye se nuk e ka më zërin pyjor, por ka zërin pemëtorë, në rastin konkret ullishte. Dhe për të dashur bashkia ta rijapë në përdorim, nuk e jep dot tashmë, sepse ka marrë një status tjetër pronë. Po vijojmë normalisht me verifikimin dhe do të dalim me një informacion të përmbledhur për të gjithë zonën.

-Ndue Luli: Fjalën e ka zoti Ndreca. Shkurt, të lutem.

-Erin Ndreca: Thjesht doja të shtoja diçka. E kam përsërit edhe herë tjetër, edhe duhet ta përsëris edhe tani: duke marrë shkas dhe nga mendime shumë kontradiktore, jemi këtu për të marrë vendime për të mirën e qytetarëve dhe banorëve të bashkisë. Nuk arrij të kuptoj, kur vjen puna në gjëra që nuk kemi ne për të vendosur, siç ishte rasti i rrugës në Shëngjin, Bypass-it, u tha mirë kështu e ashtu, por qeveria shumë vonë, vonë, vonë, domethënë, ka penguar zhvillimin e zonës. I bie që jemi kundër vonesave. Kur vjen puna të diçka që e kemi në dorë ne, themi: "Jo, po, ta shtyjmë." Jo, po, pse? Pa argumenta. Tani, marrë shkas nga hera e shkuar, ne nuk kemi pse pengojmë biznese që duan të zhvillojnë, të ecin përpara dhe sidomos në zona të vështira. Pastaj, jam shumë, shumë dakord, siç folën dhe parafolësit, që këtu të shikohet, të vëzhgohet, të penalizohet, por nuk është detyra jonë që t'i penalizojmë, as që t'i japim verdiktin se ne e japim sipërfaqen pyjore dhe përfundon diçka tjetër. Janë struktura të tjera. Prandaj, mos të humbim kohë me gjëra që janë jashtë tagrit tonë, thjesht sepse njëri do të mendojë ashtu, por tjetri kështu. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Zoti Noka.

-Pjeter Noka: Edhe i duam bizneset, edhe s'i duam bizneset. Edhe i duam taksat, edhe s'i duam taksat. Mendoj që, për këtë që po bëjmë, është pak e vonuar. Mos i frikësojmë bizneset, akoma pa fillu punë. Dhe taksat duhen. Tokat e lira t'i japim. Pse t'i vonojmë akoma?

-Ndue Luli: Faleminderit. Atëherë, kush është dakord me projektvendimin? Ju lutem, kartonat. Miratohet me 30 vota PRO. Këshilltarja Alfrida Marku votoi Kundra, 1 votë Kundra. Këshilltarët Soveljan Kosova, Donika Haxhia, Donika Ndoj votuan Abstenim, 3 vota Abstenim. Faleminderit.

Kalojmë te pika 6, Projektvendim "Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit për ndërtimin e Qendrës ditore të Moshës së Tretë në Lezhë".

Kemi diskutuar disa herë për një problem të tillë, nqs ka ndonjëri nga ju ndonjë gjë, mund ta thotë. Po zoti Marku.

-Agostin Marku: Është gjë shumë pozitive. Ne pamë edhe kur u firmos marrëveshja, ishim këtu, shpyr që po realizohet. Me kalimin në këshill, besojmë do të konkretizohet. Vetëm se unë bëj vërejtje kështu dhe kanë filluar dhe më marrin në telefon, madje disa thonë: "A ta bëjmë kështu, a ta bëjmë ashtu?" Nuk them asgjë jashtë ligjit, por s'e besoj se drejtoria e shërbimit të kujdesit

social dhe aseteve t'i vënë këtë barrë kaq të madhe që ta konkretizojnë këtë marrëveshje. Pra, kjo barrë i takon bashkisë dhe shkruhet kryetari i bashkisë. Pra, te pika dy, për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Zonja Gjoni.

-Flutura Gjoni: Unë kam qenë edhe në firmosjen këtua, kam qenë edhe jam pro dhe do të jem për çdo financim, donacion që do të bëhet në Bashkinë Lezhë, por s'kam parë afat. Kuptohet që në vitin 2027 do të akordojmë një fond prej 30 milionë lekë për mobilimin. Mobilimi s'bëhet pa qenë e mbaruar, por e shkruar kështu e zeza në të bardhë nuk është. A thu mos duhet me u shkru? Kaq kisha.

-U largua këshilltari Erin Ndreca.

-Ndue Luli: Faleminderit. Tjetër ka? Nuk ka. Në lidhje me këtë që thotë zonja Gjoni, zotë kryetar, ju lutem.

-Pjerin Ndreu: Problemi për mua nuk është ky, problemi është te banesat që janë aty. Tani unë do ta shpjegoj këtë rast për t'i bërë thirrje, kemi tre mënyra për akomodimin e banesave që janë totalisht të paligjshme, të zaptuara pas kishës. Nuk do i hyj kësaj rëndësisë, pse duhet, e pse s'duhet. Është një donacion të cilin ne e kemi luks që ta pranojmë. Kanë bonusin e qerasë, kanë kreditë e buta, kanë një variant tjetër që ne do ta nisim besoj në janar. Kemi mbi 100 apartamente me Entin e Banesave që do i ndërtojnë në Lezhë. Pra, ka tre variante ku ata mund të aplikojnë. Po që të vënë kushte dhe të thonë që ne jo, po kështu, jo, po ashtu, jo, po këtë, këto kushte nuk diskutohet që do dalin në janar, ne bëjmë gati sheshin e ndërtimit për kompaninë. Kompania mund të fillojë menjëherë. Po, nuk ka punë tenderimesh, se janë me fondet e veta. 300 mijëshja është me tonat për arredim. Pra, vjen mbasi ta mbarojnë që natyrshëm, kjo do të thotë se do ta mbarojnë brenda 2026. Po procedurat janë procedura dhe nuk mund të fillojmë në mënyrë arbitrare. Normalisht do kalojë në këshill, do e konfirmojë prefekti, pastaj do i bëjmë të qartë për këtë këshillit që do të bëhet një investim dhe mbi bazë të atij investimi familjet do lëvizin. Ky është problemi. Edhe njëherë, ju kërkoj edhe ju këshilltarëve që të qartësoni njerëzit. Ti s'mund të rrish aty pambarimisht. S'ka shans, s'ka si të rrish. Se ne do jemi edhe me ish-shtëpinë e oficerave, me familje aty. Ajo në fakt është pronë e bashkisë. Të jap bonusin e qerasë, shko apliko për banesë sociale që ne do bëjmë me Entin e Banesave, ose për kredi të butë. Ka disa variante. S'do me zgjedh asnjërën, se të tekët ty mos me zgjedhë. Është problemi jot.

Janë informuar disa herë, i kemi thirrë te bashkia, por kanë gjetur ca emisione investigative që besojnë se i ndihmojnë ata, e vijnë vërdallë. Ka nga ata që kanë aplikuar për bonus qeraje edhe për kredi të butë.

-Ndue Luli: Faleminderit kryetar për sqarimet. Atëherë, kush është dakord me projektvendimin duke shtuar atë ndryshimin që e cilësuam pak më lart? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 33 vota Pro. Faleminderit.

Kalojmë te pika 7, Projektvendim "Për miratimin e shpërblimit për 20 maturantët me mesataren më të lartë në Maturën Shtetërore 2024-2025". Po zoti Marku.

-Agostin Marku: Tani, unë e kam me drejtorinë arsimore. Unë e shoh se kanë marrë për bazë atë që ka sjellë zyra e arsimit dhe kanë marrë nxënësit të cilët kanë mbaruar shkollën në Lezhë. Unë dyshoj se jo të gjithë janë banorë të Bashkisë Lezhë dhe vendimin do ta ktheni në nul. Në qoftë

se në këtë listë prej 20 vetash ka banorë jo të territorit të Bashkisë Lezhë, ky vendim nuk do të kalojë. Prandaj, në qoftë se është një diçka e tillë, na thoni dhe o ta shtyjme, ose në qoftë se i keni si janë, t'i heqim sot nga vendimi.

Edhe njëherë, Bashkia Lezhë ka për detyrë të shpërblejë, të sponsorizojë, të nxisë banorë të territorit të Bashkisë Lezhë. Se ka të bëjë me një stimulim. Nuk jena tu dhënë një të drejtë burse ne si ia japim shkollës "Kolin Gjoka". Jemi tu dhënë një stimulim për banorët e qytetit të Lezhës.

-Donika Haxhia: Kuptoj, por shkolla është në territorin e Lezhës. A paguajnë ata? Kjo është një mënyrë edhe për të thith nxënës.

-Agostin Marku: Tani, ne mund të bëjmë debat gjithë ditën o Donika. Unë po them ky vendim dhe nesër, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Bashkisë Lezhë, në qoftë se i gjen me këtë që i ka dhënë një banori jashtë territorit të Bashkisë Lezhë, e ka në shkelje financiare. Po të pyetem unë personalisht, unë them është pak kuota 25000 lekë. Pra, unë jam që stimulimi të jetë edhe më i lartë. Pse? Janë nxënës të cilët për tre vite kanë arritur një mesatare të lartë. Ama ne nuk mund të japim shpërblime të tilla për banorë jashtë territorit të bashkisë Lezhë. Pikë. Faleminderit.

-Ndue Luli: Ka kush tjetër? Drejtoria e Arsimit atëherë.

-Altin Pergjergji: Përshëndetje.

Në fakt ne i kemi bërë kërkesë ZVA-së për të na sjellë 20 maurantët me mesataren më të mirë. Ata maurantë që kanë mbaruar maturën në Lezhë kuptohet, tashi në qoftë se një maurant nuk banon në Lezhë, por maturën e ka bërë në Lezhë, ne nuk i kemi parë në këtë aspekt. 20 maurantë që kanë mesatare më të lartë. Në qoftë se kjo është diçka që duhet të shikohet, patjetër që do e shikojmë.

-Pjerin Ndreu: A mund të bëj një ndërhyrje unë tashi, me logjikë?

-Ndue Luli: Po, zoti Kryetar.

-Pjerin Ndreu: Unë mendoj se ne përgjigjemi për banorët që kanë gjendjen civile në Lezhë. Nuk du me diskriminu askënd, por kjo zgjidhja e të tjerëve mund të jetë një zgjidhje ndryshe, por jo e fondeve të Bashkisë Lezhë, trajton nxënësit që jetojnë këtu, që i kanë familjet këtu, kanë gjendjen civile këtu. Në çdo shërbim që japim ne, në çdo lek që shpenzojmë ne, ne shpenzojmë për banorët që jetojnë brenda territorit të Bashkisë Lezhë. Kjo është e qartë.

-Altin Pergjergji: Kryetar, diçka që po mendoj tani. Normalisht ligjërisht nuk mund të regjistrohesh në shkollë në Lezhë nëse nuk je banor i Lezhës, me pashaportizim.

-Pjerin Ndreu: A ka mundësi me më dëgju? Kur e merr ai këtë shpërblimin, ku e ushtron veprimtarinë? Ku e shfaq talentin ai?

Atëherë unë nuk jam përfituesi i investimit që kam bërë. Përfituesi i investimit që bëj unë duhet të jetë në territorin tim.

Për mendimin tim, kjo është e qartë. Bashkia X atje mund të bëjë qasjen e vet. Unë jam dakord që ne të shikojmë edhe studentë prej Lezhe që janë ekselentë në fakultet, por që ne mund të ndërhyjmë me një fond që t'i suportojmë. Por ne e bëjmë politikën tonë duke mbështetur njerëzit që banojnë këtu. Kaq e thjeshtë është.

-Agostin Marku: Janë dy propozime. Propozimi që ta shtyjme ndoshta shkon vonë. Propozimi që ta miratojmë sot, ta miratojmë me këtë klauzolë. Drejtoria përkatëse të shohë të gjithë ata që nuk janë banorë të Bashkisë Lezhë dhe të hiqen nga ky vendim.

Në këto kushte, drejtoria arsimore e bashkisë t'i kërkojë zyrës përkatëse, pra zyrës arsimore vendore të Lezhës, se ajo i nxjerr kush është nga Lezha, kush s'është nga Lezha, dhe të sjellë njëzet nxënës që janë banorë të Lezhës, dhe ne ta miratojmë këtë në parim si vendim dhe të konkretizohet. Kaq.

-Ndue Luli: Zoti Artan.

-Artan Ndreu: Kam dy fjalë edhe unë. Dhe shpjegoj drejtëpërdrejt qartë. Nuk mundesh me kenë në shkollë të Lezhës po nuk pate një dokument se je banor i Lezhës, a me qera, mos të bëhet një diskriminim. Këtu po bëhet politikë qesharake sikur na kanë thënë shkollë. Për një M që ti s'e vë, fjala mik bëhet ik, bëhet kështu për këtë çështje. Kjo është me u tall. Ore shyqyr që mësojnë. Ata kanë dokumentat e shkollës aty, janë banorë të Lezhës. S'u ba nami për 25000 lekë a 50 mijë lekë, jepini nëse keni mundësi. Mos të bëjmë politikë qorre. Është diskriminim.

-Pjerin Ndreu: Tani, ka shkolla që i kanë nxënësit pa qenë fare banor i Lezhës, shkollat private, te shkollat publike, normalisht që e kanë vendbanimin në Lezhë. Tani, shkollat publike nuk na ka lënë kush ne me interpretu, fare. Ndërsa, shtrohet problemi te shkollat private. Edhe i japim, se s'është ndonjë problem i madh me i dhënë. Por me logjikën e qasjes tonë, ne qasemi ndaj qytetarëve që janë brenda Bashkisë Lezhë, kaq. Sepse ligjërisht ne për ata përgjigjemi.

-Agostin Marku: Shiko tani. Nuk është faji im se njerëzit i marrin letrat në zarf e i lënë në zarf, nuk i lexojnë. Këtu ke nga 20 vetë, 12 vetë te Rogacionistët, që te Rogacionistët vjen prej Sarandë deri në Shkodër, nga Kukësi deri në Fushëkuqe, i cili nuk kufizohet për të ardhur aty. Nuk ka asnjë smirë, asnjë gjë se këto janë para të bashkisë edhe shyqyr që bashkia i jep, e ku me e marrë me u dhënë të diturve, edhe këshilli i bashkisë me u mbush me të ditur dhe jo me hamej. Faleminderit.

-Pjerin Ndreu: Këtu ngrihet një problem. Shkresa e Ministrisë së Arsimit për mendimin tim është e pasaktë. Ministria e Arsimit nuk mund të disponohet për shkolla private për të paguar lekë. Ata që paguanë lekë e kanë një standard jetese dhe shumë më lartë se të tjerët dhe munden, nuk kemi pse i suportojmë me lekë ne. Më vjen shumë keq. Shkollat që marrin pagesa, mund të stimulojnë vetë ata e mund t'i mbështesin vetë dhe këtu nuk kemi pse hyjmë ne fare. Ne hyjmë te shkollat publike. Dakord? Dhe këto duhet të përjashtohen menjëherë në kuptimin e qasjes. Shkollat që janë me lekë kanë nivel financiar. Shkollat me pagesë private nuk mund të hyjnë.

-Soveljan Kosova: Në qoftë se mund të keni një qëllim me u dhënë ca lekë apo një diçka të vogël, kalamajve se ka halle edhe nuk kanë mundësi të shkojnë në shkollë, kanë shku te shkollat shtetërore. Ndoshta, ndoshta ky është mendimi jot, por nuk është kështu. Ne do të stimulojmë nxënës që mësojnë. Ndaç që mësojnë në shkollë private, ndaç që mësojnë në shkollë shtetërore. Absolutisht po. E në qoftë se ti do me i stimulu ata kalamaj që janë në nevojë, ka skema të tjera. Ne flasim për ekselencë. Ekselencia nuk ka lidhje as me gjimnazin, as me gjimnazin jo publik, se është është njëlloj si ai, si ai. Për Ministrinë e Arsimit, për ZVA-në, për gjithkënd. Domethënë, institucionet arsimore janë njëlloj edhe flasim për ekselencë, fëmijë që mësojnë, jo fëmijë me halle, fëmijë me halle që s'mund të shkojnë në shkollë.

-Pjerin Ndreu: Jam dakord me logjikën. A ka mundësi ta fokusojmë këtë me nxënësit që kanë vendbanimin në Lezhë?

Por ama, qenia banorë të Lezhës me gjendjen civile për mua duhet të jetë kriter. Unë bëj politikë për nxënës që jetojnë në Lezhë.

-Ndue Luli: Atëherë, ju lutem, atëherë kush është dakord që 20 fëmijët apo nxënësit e shkollave të Lezhës, të cilët kanë kritere nga zyra arsimore vendore, të marrin këtë shpërblim nga bashkia, duke qenë edhe banorë të Bashkisë Lezhë? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 33 vota Pro. Faleminderit.

-U largua këshilltari Emanuel Perjaku.

-Ndue Luli: Atëherë vazhdojmë me pikën 8, Projektvendim “Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD) dhe Bashkisë Lezhë, si dhe miratimin e përdorimit të fondeve për organizatat e shoqërisë civile të miratuar me VKB nr. 99, datë 19.12.2024”. Ka kush diçka? Kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 32 vota Pro.

Kalojmë te pika 9, Projektvendim “Për miratimin e marrëveshjes së përbashkët ndërmjet komunës Cetinje (Prejstonica Cetinje) dhe Bashkisë Lezhë për projektin “SMART LAND 2.0. - Lëvizshmëria e Qëndrueshme e ndërlidhur me Transportin Publik në Zonat Rurale në Adriatikun Jugor”. Kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 32 vota Pro. Faleminderit.

Kalojmë te pika 10, Projektvendim “Për shpalljen Qytetar Nderi i Bashkisë Lezhë të sportistit Jorgen Uldedaj”. Kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 32 vota Pro. Faleminderit.

Kalojmë te pika 11, Projektvendim “Për miratimin e Planit Tematik Vjetor të Këshillit të Bashkisë Lezhë për vitin 2026”. Ky plan tematik është diskutuar edhe në kryesinë e këshillit. E paraqesim para jush sot. Kush është dakord me planin? Po zonja Marku.

-Alfrida Marku: Është një sqarim. Kur kemi diskutuar në kryesinë e këshillit këtë projektvendim, e kam pa të arsyeshme që në vitin 2026, ne si këshill bashkiak të ndërmarrim iniciativën që konsultimet publike t'i zhvillojmë në çdo njësi administrative. Dhe këtë e kam propozuar që të reflektohet në ndryshimet e projektvendimit, sepse konsultimi publik dy-tre njësi administrative të grupuara nuk më duket efektiv.

-Ndue Luli: Qartë. Ky propozim i juaji nuk është futur në tematikën e këshillit për vitin e ardhshëm, duke u nisur nga suksesi që kemi patur në dëgjesat publike edhe me dy-tre njësi administrative, ku vetëm sivjet po të kishin qenë këshilltarët tanë dhe nderuar, do kishit parë me sytë tuaj se çfarë dëgjesash publike janë zhvilluar me një pjesëmarrje tepër masive që të paktën tash pesë vjet që e ndjek nuk e kam parë. Kush është dakord? Ju lutem kartonat. Miratohet me 31 vota Pro. Këshilltarja Alfrida Marku nuk votoi.

Kemi informacionin mbi realizimin e buxhetit për 10 mujorin e vitit 2025, informacion i cili është marrë nga secili prej nesh. Kush ka ndonjë diçka në lidhje me këtë informacion, mund të bëjë pyetje. Ka kush? S'ka. Atëherë ky është informacioni.

Kalojmë te tre projektvendimet shtesë.

Projektvendimi i parë ka të bëjë me shpalljen e datës 1 mars si festë lokale, dita e Arbëreshëve. Kush është dakord me projektvendimin? Po zoti Marku.

-Agostin Marku: Unë jam shumë dakord në parim që të realizohet një gjë e tillë. Kam diskutuar dhe me përfaqësues të bashkisë. Në parim, projektvendimi i prek ashtu siç duhet disa gjëra, por jo disa të tjera. Për shembull, unë s'mund ta kuptoj pikën katër që thotë: "Vendosi rrit promovimin e Lezhës", pra dhe si formulim nuk shkon. Ndaj edhe me konsultimin që kam bërë me përfaqësues të bashkisë, unë kam përgatitur një projekt që nuk është alternativ, por është i njëjtë, por që përcakton qartë shpalljen, i krijon akses bashkisë edhe për marrëveshjet me ku ka Arbëreshë, ku ka mundësinë që të lidhë edhe marrëveshje, në mënyrë që kjo festë që ne e shpallim festë për territorin, festë lokale për territorin e Bashkisë Lezhë, të realizojë me gjithë mend atë që ne duam, që të promovohet gjithçka e mirë dhe t'i shërbejë Bashkisë Lezhë dhe të gjithë atyre zonave që kanë Arbëreshë. Unë mund ta lexoj krejt shkurtimisht.

Pra, kjo pjesa e parë është: "Shpallja e datës 1 mars dita e Arbëreshëve në territorin e Bashkisë Lezhë. Kjo ditë përfshihet në kalendarin zyrtar të aktiviteteve vjetore të bashkisë dhe gëzon statusin festiv e kulturor në nivel vendor. Qëllimi i kësaj dite është promovimi, ruajtja dhe transmetimi i trashëgimisë kulturore gjuhësore dhe historike të komunitetit Arbëresh. Objektivat kryesore janë: nxitja e marrëdhënieve me komunat arbëreshe në Itali, përcjellja e vlerave arbëreshe tek brezat e rinj, prezantimi i kulturës arbëreshe si pasuri e identitetit lokal dhe kombëtar, organizimi i aktiviteteve që mbështesin edukimin kulturor, promovimin e turizmit dhe bashkëpunimin institucional, miratohet gjithashtu hartimi dhe zbatimi i një programi të përvitshëm aktiviteteve me datë 1 mars, i cili përfshin: simpoziume, konferenca dhe diskutime mbi historinë, gjuhën dhe kulturën arbëreshe, panair kulturor me prezantimin e traditave të kulinarisë, artizanatit dhe veshjeve arbëreshe, aktivitete edukative dhe shkollore dedikuar kulturës arbëreshe, koncerte, recitale muzikore, ekspozita dhe prezantime artistike, takime dhe shkëmbime me delegacione nga komunat arbëreshe, nismën "Java Arbëreshë" me aktivitete që i paraprijnë datës 1 mars. Për organizimin, Bashkia Lezhë autorizohet të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me komunat arbëreshe dhe institucionet kulturore të komunitetit arbëresh në Itali. Bashkia mund të aplikojë në programe kombëtare dhe europiane për financimin e projekteve që lidhen me trashëgiminë arbëreshe. Për realizimin e veprimtarisë së ditës së arbëreshëve, parashikohet një fond i dedikuar në buxhetin vjetor të bashkisë. Shoqëria Civile e Bizneset dhe fondacionet mund të kontribuojnë financiarisht në këtë fond. Dhe tjetër, bashkia harton një plan komunikimi, dhe tjetër për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë. Pra përfshihen të gjitha.

-Ndue Luli: Fjalën e ka drejtoresha e kulturës.

-Jona Dividi: Faleminderit për dhënien e mundësisë që të shprehim dhe ne mendimin tonë. Përsa pashë, dhe kuptova, ju kishit paqartësi në lidhje me pikën katër, apo jo? Rrit promovimin e Lezhës, nuk e di pse e keni të paqartë, sepse normalisht, duke funksionuar në këtë mënyrë dhe me të gjitha ato pika që ju sapo lexuat, është shumë e qartë që patjetër rrit promovimin e Lezhës në tematika të caktuara, siç është në këtë rast dhe pjesa e Arbëreshëve. Sepse me një aktivitet të tillë, kaq të gjerë, ne jo vetëm promovojmë Lezhën, por gjithashtu ne thithim dhe turizëm që quhet në këtë rast Turizëm Kulturor. Pra, ne i japim një lloj tjetër niveli dhe pjesës turistike, ndërkohë që është një nga të vetmet qytete, dhe ju siguroj për këtë që Lezha do të jetë një nga të parët qytete që do të vendosë një aktivitet të përvitshëm për sa i përket kulturës, traditës dhe

historisë së Arbëreshëve, që është shumë e rëndësishme për ne. Pra, ne, jam shumë e bindur dhe besimplotë që do të jemi një nga qytetet shembuj në krahasim me qytetet e tjera të Shqipërisë për idenë dhe rëndësinë e këtij aktiviteti për ruajtjen e vlerave dhe trashëgimisë kulturore.

-Agostin Marku: Atëherë, faleminderit. Tani, kjo që thoni ju, zonja drejtoreshë, ne marrim vendime dhe në marrjen e vendimeve, ne nuk mund ta shkruajmë pika katër: "Rrit promovimin e Lezhës". Ne vendosim, jo "rrit promovimin e Lezhës". Pra, edhe mënyra, trajta se si është shkruar, është shkrujt gabim.

Unë nuk po të them relacionin. Te relacioni, ti mund të thuash: "Kemi këto objektiva, bëjmë këtë, do rrisim, do promovojmë këto dhe të tjera." Te vendimi, vendimi është vendim. Te vendimi, nuk mund të shkruhet "rrit promovimin". Vendosi, rrit promovimin. Ma ligjëro ti edhe mësuese Donika, edhe unë jam dakord.

-Donika Haxhia: Të them diçka si mësuese gjuhe, Agostini ka shumë të drejtë tek fjala që thuhet propozoj. Ndërsa ju, e motivuat me objektivin dhe si objektiv është krejtësisht i saktë. Unë po doja të flisja këtu. Nëse lart në kokë e shkruaj "propozoj", ajo nuk del aty. Ndërsa te objektivat që thatë ju, po është krejt e saktë.

-Alfrida Marku: Unë mendoj se nuk ka vend t'ia zbehim shkëlqimin atij projektvendimi me korrigjime lehtësisht të realizueshme. Meqë jemi tek 1 marsi, dhe unë e vlerësoj, unë kërkoj vëmendjen e bashkisë, e drejtuesve të bashkisë, që me autoritetin që ata kanë të nxisin përshpejtimin e miratimit të datës 2 mars si ditë të festës zyrtare kombëtare. Është një proces i zvarritur, është një procedurë që në dijeninë time ka kaluar në komision parlamentar, por ende nuk ka kaluar për diskutim dhe miratim në parlament. Kërkoj vëmendjen tuaj për të nxitur marrjen e këtij vendimi shumë të rëndësishëm për Lezhën. Por njëkohësisht, kërkoj edhe vëmendjen e të gjithëve atyre që na përfaqësojnë në parlament, që të kujtohen jo vetëm për raste të tjera, por edhe për simbolika jashtëzakonisht të rëndësishme sikurse kjo, sepse 2 marsi është pikërisht baza, themeli edhe identiteti jonë. Dhe uroj dhe besoj që ata që na përfaqësojnë në parlament, mos t'ua atashojmë atë shprehjen: "Ra ky shi edhe u pamë". Të kujtohen për Lezhën edhe për raste të tilla. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Tani, para se ta hedhim në votim, kam diçka. Zoti kryetar i bashkisë, po jua them ju direkt këtu në këshill, sepse shumë projektvendime, nuk është ky i pari mund të themi, por kemi shumë të tjerë, të cilët nga ana juridike na vijnë me defekte teknike të vogla, por faktikisht edhe nga ai që s'është jurist, dallohet. Kërkoj që nga ana juaj, drejtoria juridike të ngarkohet, para se të vijnë projektvendimet në këshillin bashkiak, të kalojnë nga zyra juridike për të parë gjithçka që ka të bëjë me vijueshmërinë e atij projektvendimi.

Dhe për projektvendimin që kemi në fjalë, kush është dakord që ta miratojmë me ato ndryshime teknike të vogla, se shumë mirë e thanë këshilltarët, nuk ka ndonjë gabim të madh aty, por gjëra teknike të cilat ja vlejné për t'u rregulluar. Kush është dakord? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 32 vota Pro. Faleminderit.

Projektvendimi i parafundit, ka të bëjë me miratimin e krijimit të bandës muzikore të qytetit. Fjala për nënkryetarin.

-Agostin Marku: Përveçse në krye, si e kisha për vendimin tjetër, duhet të shkruajë se kush e propozon. Te pika një, krijimi i bandës muzikore të qytetit prej 18 instrumentistësh dhe një

dirigjent sipas listës bashkëlidhur. Këshilli i bashkisë nuk merr vendim për emra, është kryetari i bashkisë që i vendos. Ndaj, kërkoj mirëkuptimin që ta riformulojmë krijimin e bandës muzikore të qytetit prej 19 vetë, nga të cilët 18 instrumentistë dhe një dirigjent. Edhe pikë. Dhe pastaj vazhdon vendimi. Po të shkruajmë listë ne aty, ai ikën nesër, ikën pasnesër, e ne të rrimë tu ndryshu vendime përditë. Kompetencën për të vendosur se kush është muzikanti me emrin konkret, edhe violina, çiftelia, e tjera, e tjera, e ka kryetari i bashkisë, nuk e ka këshilli i bashkisë. Faleminderit për mirëkuptimin.

-Ndue Luli: Faleminderit. Atëhere, kush është dakord me projektvendimin me atë që e cilësuam pak më lart? Pa listë emërore. Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 32 vota Pro.

Kalojmë tek projektvendimi i fundit, u tha që në fillim. Është një projektvendim i cili ka të bëjë pikërisht me komunitetin e Bashkisë Lezhë, për t'u marrë në shqyrtim pagesa e tarifave për ujin e pijshëm dhe për pastrimin, ose më mirë të themi, për trajtimin e ujërave të ndotura. Kërkohet nga shoqëria anonime e Ujësjiellës Kanalizimeve Lezhë, që në këshillin bashkiak të jepet mendimi për mos ndryshim të këtyre tarifave.

Tani, të jepet mendim, thonë ata. Ata thonë mendim, ne dalim me vendim, nuk japim mendim. Kështu që, ta dini që projektvendimi ka të bëjë me këtë: mosndryshimin, pra vendim për të mos ndryshuar taksën dhe tarifën e ujit të pijshëm.

-Donika Haxhia: Me ata është kot se ne votuam mos me e rrit dhe ata e bënë vetë.

-Ndue Luli: Nuk e bëjnë vetë, se e keni marrë një vendim dikur e s'e kanë bërë.

-Agostin Marku: Atëhere, me leje, jam dakord me Donikën. Ne herën tjetër thamë mos të ndryshojë, ata e ndryshuan, por vetëm një korrigjim du me bë te kryetari. Mos të themi mosndryshim, të themi mosritje. Mosritje, se po na e rrisin prapë.

-Ndue Luli: Lënie në fuqi të çmimit të mëparshëm. A jeni dakord me këtë? Lënie në fuqi të tarifave ekzistuese të ujit të pijshëm.

-Alfrida Marku: Unë jam që ta ndryshojmë vendimin ekzistues duke e ulë tarifën.

-Ndue Luli: Kjo që thoni ju do kohën e vet, por kush është dakord me këtë projektvendim që ne ta lëmë në fuqi, ashtu siç është, tarifën e ujit të pijshëm, ju lutem, kartonat.

-Alfrida Marku: Ju lutem. Për një rresht, nënkryetari i këshillit bashkiak mori një minutazh, të paktën nja 15 minuta për një rresht që ishte aty, për një fjalë që ishte te një projektvendim i mëparshëm, që në gjykimin tim aq e vlefshme është ajo iniciativë, sa ne duhej t'ia kishim kursy atë interpretim me plot patos që u bë këtu. Kështu që, unë mendoj që ju pikë së pari duhet me na vu në dispozicion projektvendimin që ne ta analizojmë edhe ta diskutojmë edhe më në fund të vijojmë me qëndrimin tonë. E konsideroj absurde dhe shkelje nga ana juaj.

-Pjerin Ndreu: A mund të bëjmë një interpretim? Personalisht, me cilësinë e kryetarit të bashkisë, ne marrim pjesë në 30% të aksioneve në ujësjiellës kanalizime. Personalisht, ka një vit që unë e kam braktisur atë dhe refuzoj të marr pjesë për arsye se në bilanci financiar të para ngritjes së tarifave, Ujësjiellësi i Lezhës ka qenë rentabël. Pra, ka pasë mbulu shpenzimet e veta. Në organizimin me bazë ka qenë Laçi dhe Mirdita. Domethënë, ne si popullsi më e madhe na u shtu tarifa dhe ne mbyllim gropat e Laçit e Mirditës, për krejt respektin që kam unë për banorët e

tyre, ne nuk mund të disponohemi me lekët e banorëve tanë, të mbushim arkën dhe unë e kam kërku me të madhe këtë. Kam bërë zhurmë. Fatkeqësisht, ne kemi nënshkruar një marrëveshje ku ka një klauzolë aty. Unë mendoj që ne duhet të marrim një iniciativë si këshill që të mbajmë qëndrim jo për ta rrit, jo e jo, që s'bëhet fjalë. Se s'ka pasur ndonjë problem financiar Ujësjiellësi i Lezhës. Do të thotë që ka qenë në rregull. Edhe me një test që kemi bërë ne sot me një kompani private, më thotë që në të gjithë pusetat, kanalet poshtë, kena nxjerrë, mineral.

Ne duhet të ulemi dhe duhet të formatojmë një mënyrë qëndrimi tjetër, duke e çu çështjen në gjyq. Përse? Duhet të na sjellin bilancet financiare, të na kthehen shumat që kanë paguar njerëzve. Përse ne paguajmë më shumë sesa shpenzimet? Sa shpenzime ka kryer Ujësjiellësi i Lezhës me lekët që i ka marrë dhe ku?

Ne duhet t'i kërkojmë përpara këto materiale. Mbi bazën e këtyre materialeve, ne duhet të ulemi. Unë jam dakord për me fillu një histori, sepse këta të qeverisë tonë e kanë bërë në mënyrë arbitrare këtë histori. Pra, ka ardhur një moment që ne ose do mbrojmë interesat e banorëve, ose do i bëjmë fresk qeverisë. Unë nuk e kam ndër mend. Ju them që ta bëjmë këtë si këshill, ne t'i drejtohem Ujësjiellës Kanalizimeve, me na sjellë bilancet financiare dhe ku kanë shku, kaq lekë më tepër që ti ke gjeneruar gjatë kohës që është rrit tarifa. E të më thuash mua çfarë investimesh janë bërë në Lezhë këtë vit? Dhe ne pastaj të nxjerrim konkluzion ku shkojnë lekët. Se mirë, dakord, nuk jam kundër, se për shkak të këtij menaxhimi që ka pasur Lezha, ne e kemi stimuluar, por kjo s'do të thotë ë t'i çosh lekët atje. Në qoftë se ti i ke mbuluar dhe je mirë financiarisht në më të mirët, atëherë je me lekët e mia. Se i ke çuar atje, i ke mbuluar humbjet. Sa paguajnë në bashkitë e tjera? Cila është tarifa? Sa paguajnë? Sa përqind e popullatës paguajnë aty? A i mbulojnë shpenzimet e veta a s'i mbulojnë? Nëse s'i mbulojnë, i mbulokemi ne. Pra, ka diçka për të hetuar këtu dhe ne si këshill mund ta bëjmë, se në fund të fundit mbrojmë interesin publik, mbrojmë lekët tona. Dhe unë jam i shqetësuar për këtë punë. Për shkak të kësaj unë e kam refuzuar ka një vit. Dhe këtë debat e kam bërë me ish-drejtorin e përgjithshëm të AKUKU-t, pra, unë propozoj një kërkesë me të dhëna të sakta analitike se çfarë ka ndodhur me financat në rastin e dyfishimit të tarifës apo sa u bë, në mënyrë arbitrare. Dhe pse vjen në këshill bashkiak kur ne themi jo, e punë e madhe që është dhe jo, dhe kjo nuk shkon. Atëherë bie që ne të përdoremi si tip instrumenti palidhje, domethënë po deshe. Domethënë, unë mendoj që ne duhet të refuzojmë ta marrim në konsideratë.

-Ndue Luli: Ka mendim tjetër? Po zoti Zek.

-Zek Doda: Ky projektvendim për ujin e pijshëm unë du të shtoj diçka. Për shembull, pagesa. Kjo është me pagu. Se kush është drejtori, unë nuk e di.

-Pjerin Ndreu: S'ka faj drejtori në këtë mes. Ky nuk është problem drejtori. Ky është problem tjetër.

-Zek Doda: E kisha te pagesat e privatëve. Nuk ka dhënë firmën për të paguar njerëzit. E presin në radhë aty në kat të tretë. Këtë kisha unë.

Një kompani që njoh unë më thotë: "Nuk më jep firmën drejtori i Lezhës."

Me e pagu në derë të shpisë.

-Ndue Luli: Fjalën e ka zoti Gjinkola.

-Pjeter Gjinkola: Për ujin e pijshëm, se kam 3-4 mbledhje që e kam ngrit këtë problem unë.

Unë e kam ngritur si problem, sepse unë kam qenë anëtar i këshillit në Komunën Shëngjin me vite, dhe aty na kanë ndodh për shembull, investime të ndryshme nëpërmjet Ujësjellës Kanalizimeve, dhe ka ndodhur, është ba një investim në Shëngjin, për shembull, është ba depo, dhe s'ka shku ujë në depo. Është ba investimin tjetër, prapë shtesë, flas në demokraci, është ba investimi tjetër, prapë nuk ka shku ujë në depo. Në fund u bë një investim i tretë që u shtu një linjë nga Lezha, dhe vazhdojnë prapë ca lloj gjërash të çuditshme. Ka pasë dalë uji i papërdorshëm, i papijshëm. Tash dikur ka pasur borde. Nuk e kam idenë si funksionon, a ka borde, a ku di unë.

Dhe për me e mbyll, unë kam idenë teme, mendimin tem, këshilli këtu duhet të mblidhet dhe duhet të jetë shumë i kujdesshëm, shumë i vëmendshëm dhe duhet të mbajë qëndrim korrekt. Nëse na marrin mendim, ose kërkohet vendim në këshill, duhet të kuptojmë se çfarë jena tu ba. Ne atë që marrim, e marrim me gjobë, në kuptimin 100% të fjalës, Flas si qytetar këtu dhe flas në emër të një komuniteti siç është zona e Shëngjinit.

-Ndue Luli: Prandaj, po vendosim diçka tani, zoti Gjinkola.

Jeni dakord që ne në këshill të thërrasim për informacion drejtorinë e ujësjellës kanalizimeve të Lezhës, dhe në atë takim, pas informacionit, të marrim dhe vendimin për të cilin kërkohet. A jeni dakord me këtë? Kush është dakord me këtë që po them unë? Ju lutem. Ka ndonjë kundër? S'ka. Dakord.

Atëherë kalojmë te pika "Të ndryshme".

Fjalën e ka kryetari i bashkisë në lidhje edhe me atë që u tha pak në fillim.

-Pjerin Ndreu: Meqenëse këshilltarja Ndoj m'u drejtu për problemet e përmbytjeve, unë dua të bëj disa sqarime. Para së gjithash, Shqipëria është përfshirë në një situatë të pazakontë reshjesh të cilën e kemi paralajmëru edhe nëpërmjet rrjeteve sociale që mund të ketë përmbytje. Dhe pra, është një gjë të cilën ne nuk është se nuk e kemi pritur që të jemi realistë. Lezha është akoma në high risk të kësaj shtate. Ajo që ka ndodhur, që na ka nxjerrë ne në një situatë të tillë të vështirë, është plasja e argjinaturës në 40 metra. Unë kam qenë vetë atje, dhe e kam parë. Kam qëndruar aty derisa është riparuar. Kam dëgjuar plot shpjegime, kam dëgjuar shpjegime kriminale, kam dëgjuar atentate politike, kam dëgjuar veprimtari armiqësore, ça nuk kam dëgjuar për këtë histori. Në qoftë se kanë ndonjë fakt, ndonjë gjë që dikush ka kryer ndonjë veprimtari armiqësore, sabotuese, ne këtu jemi, prokuroria aty është, provojini këto aty, mund të bëhet një material. Unë kam qenë aty dhe më është shpjeguar ndryshe. Argjinaura ishte ranore, asnjë gur s'e kishte në mes. Pra, ajo duke qenë pika më afër me lagunën, ajo ka degraduar poshtë, kohë pas kohe. Kohë pas kohe, kohë pas kohe ka degraduar, si duket ka të bërë që ajo në një moment ka rënë. Po, në momentin që ka rënë, rrjedha, ka hapur gjithë krahët e argjinaturës dhe është gjetur në një situatë e cila është e pazakontë dhe është shumë e vështirë për t'u menaxhuar për arsye edhe të mungesës së rrugës. Aty s'kishte rrugë. Tre herë më është rrezikuar zona e Zadrinës për t'u përmbytur, ne s'kemi pasur problem. Për shkak të kësaj argjinaturës, ne u vumë në vështirësi, dhe kishte dy rrugë. O me u mendu gjatë dhe me fillu: "Jo po kështu, jo po ashtu." ose me marrë në dorë situatën, Atëherë jemi detyruar të bëjmë maksimumin e mundshëm me ekspertë, me firma private, me ushtri, me çfarë kemi pasur mundësi me e mbyll. Fakti që e mbyllëm, na bëri që të ulemi edhe të flemë rehat, se ajo situatë do të rikuperojë, po pa hy në shtëpi, përjashtoj një 4

shtëpi, diçka e tillë. Brenda në shtëpi nuk na i ka krijuar kujt problem, në oborre e në ara, normalisht që ka krijuar dëme, sepse ne nuk thamë që nuk na ka krijuar, dhe mendoj se ka qenë një aksident, a ka pasur një arsye tjetër, unë nuk jam në gjendje për ta shpjeguar sot. Kam lënë që të thërras të gjithë ekspertët e kësaj dhe nga ata të vjetrit që kanë qenë të kanaleve, të bordit të kullimit, ata ë janë sot, tëo nave të mbrojtura e do bëj një konsultë me ta, sepse ajo argjaturë nuk plas më, ajo që është bërë sot është çimentuar, po kush më garanton mua se nuk plas diku tjetër. Është rërë. Unë mendoj që maksimumi i asaj që mund të bëhej, është bërë. Me një heroizëm të pashembullt të atyre shoferëve dhe të atyre firmave që shumica ishin të ushtrisë, të emergjencave civile dhe të kompanive private, me dy kohë, kamionët e mëdhenj na sillnin material, të gjithë firmat u vunë në dispozicion, në kohën e dytë kamionët e vegjël ngarkoheshin dhe binin aty. Ne kemi mbaru nga mëngjesi deri në orën 9 të darkës, ku ne e kemi mbyllur dhe kemi shpëtuar një zonë të tërë.

Tani që ne jemi alert, jemi si me thënë në high risk për përmbytjet, ne jemi, ne nuk mund të bëjmë sikur s'jemi. Për shembull, në Lezhë tani ka ikur uji, për shembull. Për 6 orë ka ikur uji nga qyteti. Po ne jemi në investim tashti, ne nuk mund të pretendojmë që qyteti nuk do na mbytet derisa të mbarojë investimi i KFË-së. Besoj e keni parë se çfarë ulluqesh janë duke u vënë aty, që kalon uji lumë dhe stacioni i pompave i fuqishëm. Ne nuk e kemi sot. Edhe nuk vihet në funksion, ne do të jemi me këtë vështirësi njëherë. Kanë qenë kanalet kulluese që e kanë mbajtur vlagën pa iu hyrë brenda njerëzve. Kemi hapur pafund kanale kulluese pothuajse në gjithë zonën e ejmen, Spiten, Markatomaj, Barbullojë, Tresh, Rrilë, komplet zona , pothuajse është e trajtuar, por ne vazhdojmë punë. E kanë mbajtur ata vlagën e parë, se nëse nuk do ta kishim edhe atë gjë në dorë, sot do ishim në një tjetër situatë. Ne kemi shkuar menjëherë, kemi evidentuar shtëpitë. Cila është detyra kryesore? Ruajtja e njerëzve, jetës së njerëzve, Ne kemi evidentuar menjëherë rastet, nëse një shtëpi është në rrezik, është në pamundësi, kemi shkuar menjëherë. Evakuimi është detyra numër një në rast rrezziku dhe në rast të emergjencës. Ajo s'ishte detyra ime fare në kuptimin institucional. Ishte kanal i parë që e trajtonte bordi i kullimit. Bashkia hyri aty në rolin e rregullatorit dhe harmonizuesit të të gjithë institucioneve dhe të biznesit privat për t'i bashku dhe për të qenë si rregullator për ta bërë. Po logjikisht unë haja pasojat bashkë me ju, të njerëzve që ishin në ujë, po jo të shkakut, të arsyes. Megjithatë kjo nuk na bëri që të rrimë, t'i hedhim fajin njerit dhe tjetrit, as të gjejmë armiq, por të parandalojmë. T'i nxjerrim njerëzit nga kolapsi. Pra, unë nuk du me hy në debate se i kena ezauru publikisht. Ne do vazhdojmë. Për shembull në Barbullojë, ku bërtasin ca, kemi shku, kemi evidentuar urën aty. Një kilometër pesë ura. Pesë ura në kanal kullues. Jo, mos ma hiq urën, tha ai, jo, po do ta heq urën. Ke blloku kanalin kullues, kur mbytesh brenda ti, e mbytet e gjithë lagjja, në këtë rast më vjen e më bërtet mua. Atëherë do të them, po, do të jap leje me e bë tobinën, për atë urën, me parametrat që të them unë.

Investimi është në proces, qyteti është duke u adresuar. Njerëzit tashti, të gjithë ata që kanë humorin lart, thonë i norri me ba not. S'ka problem fare. Po ky problem është zgjidhur. Edhe problemi i argjaturës ishalla nuk na ndodh më. Unë nuk mendoj se do shkojmë në këtë situatë nëse nuk do kemi aksidente të rënda të këtij lloji. Unë mendoj se nuk ka vend për medalje, as për filanin, e as për filanin, po as nuk ka vend me tregu me gisht, unë i shpëtova, e ti s'i shpëtove. Ne nuk bërtitëm, shkuam atje te puna nga mëngjesi deri në darkë. S'folëm asnjë fjalë, nuk dhamë asnjë intervistë fare. Në darkë, kur e mbyllëm, thamë e mbyllëm, bravo na qoftë. Kështu që nuk është e mirë që të përfitojë askush, as të manipulojë, as të fantazojë, as të dalë si trim pas pilafit, as të gjejë ca njerëz që kanë nevojë, në nevojë janë, normalisht të irritum janë, edhe dalin të

bëjnë seriale. Mendoj se kemi bërë maksimumin, jam i bindur që kemi bërë të pamundurën, kur thellësia e lumit kishte shkuar në mes 5 metra. Që në një moment kam dyshu nëse do ishim apo jo të zot me e çu apo jo deri aty.

-**Ndue Luli:** Po? Kush ka? Zoti Jaku.

-**Dod Jaku:** Në lidhje me këtë problem, që tha dhe kryetari dhe kjo ishte një fatkeqësi që askush nuk e dëshiron. Në kësi rastesh duhet të kërkojmë që të jemi solidarë të gjithë dhe të bëjmë më të mirën, në mënyrën më të mirë të mundshme. Unë jam nga ajo zonë dhe për fat të keq atë rast nuk kam ndodhur aty, por i kam pa të gjitha veprimet që janë bërë dhe mënyra se sa shpejt është ndërhyrë. Unë në radhë të parë përgëzoj kryetarin, gjithë stafin e bashkisë, të gjitha institucionet të cilat ndërhyjnë, sepse unë e njoh mirë atë zonë. Ajo punë do të ishte me rrisht edhe shumë më të madh dhe me pasoja edhe shumë më të mëdha të tjera. Fati numër një është që nuk ka pasur dëmtime në njerëz. Pastaj të gjitha të tjerat rrugullohen dhe bëhen. Arsytet është e vërtetë që askush 100% nuk i din, por unë duke qenë se e njoh atë zonë dhe pak a shumë e njoh bujqësinë dhe unë dyshoj në strukturën e tokës, në mënyrën se si janë ndërtuar ato argjinatura që janë me struktura përbërje të ndryshme dhe mbi 90% ranore, qoftë kafshë të ndryshme ujore, qoftë mbeturina drusore që mund të kenë qenë të trashëguara, mund të kenë krijuar probleme me aq sa unë mund të njoh. Kanë filluar rrjedhjet e vogla dhe pastaj ka ardhur momenti që ka krijuar atë problem që u krijua, një problem që do të ishte me pasoja tepër, tepër të rënda. Dhe unë me të vërtetë përgëzoj edhe firmat private të cilat janë gjetur në gatishmëri me gjithë potencialin e tyre të mjeteve dhe janë për t'u përgëzuar.

Do të them diçka në lidhje me kullimin. Duke qenë se kam qenë pjesë e stafit të bashkisë, kam qenë drejtor i drejtorisë së bujqësisë dhe në qoftë se ka punë që është vu dorë më shumë se me kullimin, besoj edhe kryetari vetë dhe gjithë bashkia e ka pasur prioritet çështjen e kullimit dhe duhet ta kemi vazhdimisht, nuk duhet ta tërheqim asnjëherë vëmendjen nga problemet e kullimit. Nuk mund të thonë që gjithçka është perfekte, gjithçka ka funksionuar perfekt, por po most ë kishte qenë edhe sistemi kullues në nivelin e duhur, i pastruar do të kishim pasoja shumë edhe më të mëdha, ndërsa sot kemi largimet e ujit në mënyrë aq të shpejtë, se unë kam shumë eksperiencë atje, mbi 60 vjet që jetoj në atë zonë, kam punuar në atë zonë dhe i njoh, mund të them në detaje disa probleme. Dhe Barbulloja, Rrila, një pjesë e Grykës së Lumit që janë probleme më të mëdhaja, Tresh, Spiten, e gjitha historia e tyre është në katër pesë vite që është pastruar kanali. Pra, janë pastruar në atë zonë, mos qofsha gabim unë, deri aktualisht mbi 400 km kanale që para 5-6 viteve nuk gjenim gjurmën e kanalit. Flas për zonën e Bregut të Matës.

Pra, ka qenë edhe një punë e mirë që është bërë për problemet e kullimit. Unë them dhe ju bëj thirrje të gjithëve që në këto raste të bëhemi solidarë, të ndihmojmë njëri-tjetrin për të përballuar fatkeqësi natyrore që mund të jenë. Gjithashtu, unë them që bashkia duhet të ndërtojë një plan studimor që të fillojmë e të frenojmë ndërtimet dhe të caktojmë zonat ku nuk janë në nivelin e detit. Rrila, Barbulloja, Spiteni dhe Treshi, ka zona që janë edhe me 5-6 metra në nivelin e detit. Risku ka për të qenë prapë. Prandaj, ne me studime që mund t'ju paraprijmë dhe t'ju bëjmë thirrje dhe banorëve që mos kërkojnë me zhvillu më ndërtimtarinë në ato zona të cilat janë në risk përmbajtje. Faleminderit.

-**Ndue Luli:** Faleminderit, zoti Jaku. Zoti Kosova.

-Soveljan Kosova: Institucionet u vunë aq shpejt në lëvizje dhe situata u sistemua. Duhet të kuptojmë një gjë, se në lidhje me këto lloj situatash ka institucione të tjera që ne nuk e dimë edhe duhet me iu kërku llogari. Duhet me bë apel nëse e bëjnë punën se argjinaturat nuk janë objekte të rëndësisë normale, të zakonshme. Janë objekte të rëndësisë së veçantë. Ka ca institucione që ndoshta nuk janë edhe në rang bashkie apo prefekturë që duhet me iu kërku llogari. A i ka inspektu kush ndonjëherë? Ndoshta, edhe nga mungesa e inspektimit të këtyre argjinaturave ka ardhë situata. Mund të ketë pasur shenja. Mund të ketë pasur mundësi domethënë që ekspertët me i parapri kësaj. Pastaj është edhe bordi i kullimit që ka rolin më kryesor të kullimit. Me menaxhimin të këtyre objekteve e sidomos të hidrovoreve që edhe në këtë rastin e këtyre ditëve i kanë ndezur edhe pompat me vonesë. Nuk ka lidhje me atë rastin atje, por ka me të tjerët.

-Ndue Luli: Faleminderit. Zoti Trashaj.

-Alfons Trashaj: Menaxhimi i përmbytjes u krye me sukses. Unë kam qenë aty dhe e kam pa edhe vetë. Kam pa dhe kryetarin e bashkisë. Ishte një humbje e madhe për ne, për të gjithë ata banorë atje. Por përmbytjet nuk vijnë vetëm nga hapja e kanaleve. Përmbytjet vijnë edhe nga menaxhimi i pritave malore. Shumë veta dhe në shumë vende janë deviju përrenjtë. I kanë çuar në kanalin vaditës të bordit të kullimit. Kryetar duhet të shikohet në vëmendje të madhe, sidomos rruga në zonën e Zejmenit. Janë të gjitha të bllokuara sepse përrenjtë bllokohen nga familjarët. Janë deviju.

-Ndue Luli: Faleminderit. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Shënim: Mbledhja u transmetua live në Facebook në faqen "Këshilli i Bashkisë Lezhë".

SEKRETARI

Floride Sunaj
8

KRYETARI

NDUE LULI
